

SHARRCEM

a  **TITAN** Group Company

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE KORPORATIVE DHE QËNDRUESHMËRIA RAPORTI VJETOR 2019

www.sharrcem.com



contact@sharrcem.com



www.sharrcem.com



Adem Jashari 280
71510 Hani i Elezit
Kosovë



+383 290 385 500



+383 290 385 510



Shiko Online

Sharrcem SH.P.K.
**PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE
KORPORATIVE DHE
QËNDRUESHMËRIA
RAPORTI VJETOR**
2019

A decorative wavy line in a light gray color, starting from the bottom of the '2019' text and extending horizontally across the bottom of the page.

RRETH RAPORTIT

Që nga viti 2018, Sharrcepi është në përputhje të plotë me Qasjen Globale Sektoriale të TITAN Cement International S.A. (në tekstin e mëtejshëm: Grupi TITAN) në fushën e: monitorimit, raportimit dhe verifikimit të performancës së saj mjedisore, sociale dhe qeverisëse. Sharrcepi gjithashtu ka prezantuar Indeksën e Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI) për Qëndrueshmëri në Performancë, duke përfshirë një numër të gjerë të treguesve të performancës në lidhje me çështjet materiale dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për vitin 2030 dhe do t'i përdorë ato në përcaktimin e qasjes së tij për raportim në të ardhmen.

Ky raport është në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë së Grupit TITAN siç përcaktohen në lidhje me zbatimin e parimeve të Këshillit Ndërkombëtar të Raportimit të Integruar (IIRC), Komunikimit Global të Kombeve të Bashkuara mbi Udhëzimet e Progresit, Udhëzimeve të Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA) dhe Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) të OKB-së për vitin 2030. Ky Raport garantohet nga Kompania e Pavarur e Garantimit të Biznesit në Nivelin e Avancuar për Komunikimin e Progresin, në përputhje me kriteret e Kompaktit Global të OKB-së (UNGC).

Sharrcepi gjithashtu ka integruar në qasjen e tij Udhëzuesin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) për të lidhur raportimin e tij të Qëndrueshmërisë me Objektivat për OZhQ-të, duke ndjekur qasjen e Grupit TITAN. Për më shumë informata në lidhje me Qasjen dhe Standardet e Grupit TITAN në Sektorin Global, ju lutemi vizitoni Raportin Vjetor të Integruar të Grupit TITAN për vitin 2019:

<https://www.titan-cement.com/newsroom/annual-reports/>.

Në tetor të vitit 2019, Grupi TITAN ka azhurnuar fjalorët dhe udhëzimet e tij të brendshëm të qëndrueshmërisë për performancën shoqërore dhe performancën mjedisore në mënyrë që t'i harmonizojë ato me zhvillimin e sistemeve të reja të raportimit të brendshëm në të gjithë Grupin, në veçanti Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Grupit TITAN (GHRMS) është harmonizuar me Kartën dhe Udhëzimet Kornizë të Qëndrueshmërisë së GCCA.

Në të dy dokumentet mund të kenë qasje të gjitha njësitë e Grupit TITAN përmes sistemeve të Grupit për mbledhjen e të dhënave shoqërore dhe mjedisore - "CSR Databank", dhe "EPIs Database", të përdorura për të menaxhuar treguesit kryesorë të performancës në fushën e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit.



Ky është raporti i 8-të Vjetor i Sharrcemit mbi CSR dhe Qëndrueshmëri (në tekstin e mëtejshëm: 'Raporti'), i cili përfshinë periudhën nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2019. Përmbledhja dhe pasqyrat e Performancës Jo-Financiare janë verifikuar në mënyrë të pavarur nga Grant Thornton. Procedurat e duhura janë kryer për të siguruar garanci të kufizuar të këtij raporti me "Standardin Ndërkombëtar të Angazhimit për dhënien e Garancisë (ISAE) 3000.

Titulli 'Sharrcem' në këtë Raport nënkupton punët e kombinuara dhe të integruara të fabrikës së çimentos Sharrcem SH.P.K. si dhe gurorja(et) e integruara dhe të lidhura me të. Ai gjithashtu përfshin punën e filialeve të cilat janë në pronësi të plotë, "Esha Material LLC" dhe "Kosovo Construction Materials LLC" që menaxhojnë терминаlet e "Cement Plus" (në Lipjan), Терминалет në Duhël dhe Klinë, për sa i përket prodhimit të lëndëve të para nga guroret, si dhe shpërndarjen e çimentos dhe produkteve të çimentos.

Termi Sharrcem përdoret në të gjithë Raportin dhe ky term nënkupton fjalitë e shënuara më lartë. Ky Raport përfshin shifrat e konsoliduara të informacionit jo-financiar në lidhje me performancën mjedisore, performancën shoqërore dhe qeverisjen e Sharrcemit.

Ne vërtetojmë se kompania jonë amë merr pjesë në Kompaktin Global të OKB-së dhe ne mbështesim Dhjetë Parimet dhe avancimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe objektivat më të gjera të OKB-së. Ne e konsolidojmë plotësisht mbështetjen tonë për këtë iniciativë në kuadër të angazhimit të kompanisë amë. Prandaj, ne nuk marrim pjesë në aktivitetet e Kompaktit Global të OKB-së dhe nuk marrim pjesë në aktivitetet e Rrjetit Lokal të Kompaktit Global.

WE SUPPORT




TABELA E PËRMBAJTJES

Rreth Raportit	04
Pikat Kryesore 2019	08
Mesazhi nga Drejtori Menaxhues	10
Prania Globale e Titanit dhe Aktivitetet Ekonomike të Sharrcemit	14
1. PËRMBLEDHJE	16
Rreth Sharrcemit	18
Procesi i Transformimit	19
Historiku	20
Rreth TITAN-it	22
Shpërndarja e Vlerës për të Gjithë	25
Fokusi në Sharrcem	26
- A. Performanca Financiare	26
- B. Performanca Jo-Financiare	26
Materialiteti dhe Përfshirja e Palëve të Interesit	27
Objektivat për vitin 2020	30
Qeverisja Korporative dhe Menaxhimi i Rrezikut	31
Qëndrueshmëria përmes Sistemeve të Certifikuara	36
Produktet dhe Partnerët në Biznes	37
- Klientët	37

2. KAPITALI NJERËZOR DHE SHOQËROR	40
Shëndeti dhe Siguria në Punë	42
Njerëzit Tanë: Programet e Zhvillimit dhe Angazhimit	47
Angazhimi me Grupet Lokale të Interesit	56
- Kontraktorët	58
Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB)	59
Bordi i Pavarur Lokal (BOPAL)	68
Aktivitetet e Angazhimeve Tjera	69
Kontributet Shoqërore	75
3. KONTRIBUTI NË TRANZICIONIN NË KOSOVË	76
Të Drejtat e Njeriut	78
- Kodi i Mirësjelljes; Parimet dhe Procedurat; Zinxhirët e Furnizimit dhe SA 8000	78
- Furnizuesit	79
Bashkëpunimi me Organizatat dhe Rrjetet Kombëtare dhe Ndërkombëtare	80
4. MJEDISI NATYROR	86
Menaxhimi i Integruar i Mjedisit nga Sharrcemi	88
Përmirësimet në Mjedis	90
Rehabilitimi i Gurores dhe Biodiversiteti	90
Ekonomia Qarkore si pjesë e punës së Sharrcemit	91
Performanca Mjedisore	92
Ndryshimi Klimatik	93
Menaxhimi i Ujit	94
Menaxhimi i Mbeturinave	96
Vetëdijësimi përmes Trajnimeve	97
5. RAPORTI I PAVARUR I GARANCISË SË KUFIZUAR	98
6. FJALORTHI DHE SHTOJCAT	102

PIKAT KRYESORE 2019



51,682

€

Të paguara për taksa lokale
(komunale dhe në pronë)

274,396

€

Tatime në të ardhura
të korporatave

208,082

€

Të paguara për kontribute
pensionale të punonjësve
(5% të kontributeve të
paguara nga Sharrcem)

697,104

ton

Sasia totale e çimentos
së prodhuar

176,071

€

Investimet totale
(përfitimet sociale)

MESAZHI NGA DREJTORI MENAXHUES



THOMAS GLAVAS

Drejtör Menaxhues

Të nderuara Palë të Interesit,

Duke e konsideruar veten thellësisht të nderuar që kam privilegjin të prezantoj para jush Raportin e vitit 2019, do të doja ta shfrytëzoja këtë mundësi që të ndaj me ju aktivitetet kryesore për CSR dhe Qëndrueshmëri të zhvilluara nga Sharrcem SH.P.K. – e cila vepron si një kompani që bën pjesë në Grupin e Kompanive TITAN. Duke i kushtuar një respekt maksimal politikave të Kompanisë dhe duke zbatuar vlerat e Grupit tonë, të cilat janë thelbi i asaj që jemi dhe na udhëzojnë në punën tonë, ne mbetemi të fokusuar në partneritet të ngushtë me të gjitha palët tona të interesit, duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm ndaj punonjësve, klientëve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve dhe komuniteteve tona ku veprojmë, duke synuar vazhdimisht të vazhdojmë t'u shërbejmë interesave dhe pritshmërive të tyre afatgjata, duke qenë gjithnjë në linjë me

prioritetet tona të biznesit në krijimin e vlerës për shoqërinë, duke pranuar etikën si parimin absolut i cili drejton praktikën tona të biznesit si dhe duke rritur qartësinë si mënyra më efikase dhe më produktive e komunikimit.

Të nxitur nga iniciativa jonë për të promovuar vetë-përmirësim të vazhdueshëm, transparencë, zotësi dhe përsosmëri në kompetencat thelbësore, ne jemi gjithmonë duke zhvilluar plane të brendshme të veprimeve dhe i azhurnojmë rregullisht ato në mënyrë që të jemi në hap me kushtet që ndryshojnë e që mund të mbizotërojnë herë pas here, dhe në këtë mënyrë ta kemi më të lehtë të përmbushin nevojën për zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të synuara, që synojnë të inkurajojnë angazhimin e palëve tona të interesit, për të krijuar një vend pune të shëndetshëm dhe të sigurt, për të optimizuar ndikimin tonë në mjedis dhe për të mundësuar qëndrueshmërinë tonë afatgjatë në biznes.

Në këtë aspekt dhe gjatë gjithë historisë së tij të gjatë, TITANI ka qenë i suksesshëm në ofrimin e rezultateve në biznes për palët e interesit, duke respektuar njerëzit, shoqërinë dhe mjedisin, duke kombinuar gjithmonë profitin e punës me rritjen e qëndrueshme dhe duke ndarë vlerën e ngritur me palët e interesit në të gjitha nivelet. Prandaj, kemi pasur bashkëpunime aktive dhe në disa raste kemi udhëhequr, një numër iniciativash Kombëtare, Evropiane, Ndërkombëtare dhe Sektoriale, të tilla si Përgjegjësia Shoqërore Korporative (CSR) në Evropë dhe Rrjeti CSR në Kosovë si dhe Shoqata Globale e Çimentos dhe Betonit që fokusohen në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ).

Që nga blerja e saj nga Grupi TITAN në vitin 2010, Sharrcem ka investuar më shumë se dyzet (40) milion euro për modernizimin e nevojshëm teknologjik të instalacioneve, për zbatimin e teknikave më të mira në dispozicion për prodhim dhe zbatimin e standardeve të larta në të gjitha nivelet e funksionimit, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e këtij programi të madh investimi u hartua dhe implementua në mënyrë që të përmirësonte ndikimin tonë në mjedis, pas së cilës Sharrcemi arriti jo vetëm që të përmbushë plotësisht standardet Evropiane për mjedis, por edhe i ka tejkaluar standardet e kërkuara nga legjislacioni i Kosovës.

Kompania zbaton Sisteme të Certifikuara të Menaxhimit sipas sistemeve të standardeve ndërkombëtare (ISO, IPPC dhe ASI) dhe çdo vit vullnetarisht shpalos performancën e qëndrueshmërisë, duke mundësuar një komunikim të hapur dhe transparent me të gjitha palët e interesit dhe duke iniciuar progres të vazhdueshëm në të gjitha frontet.

Që nga viti 2016, Sharrcemi është certifikuar gjithashtu me Certifikimin për Standardin e Llogaridhënies Ndërkombëtare Sociale SA 8000, i cili është një hap më shumë drejt përmbushjes së përkushtimit tonë të vazhdueshëm për të menaxhuar përmes sistemeve të certifikuara, të cilat verifikohet kohë pas kohe nga organizata të jashtme të autorizuar për të mbrojtur parimet e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Në nivelin lokal dhe duke qenë prodhuesi i vetëm lokal i çimentos dhe furnizuesi kryesor i tregut në Kosovë, Sharrcemi aktualisht ka të punësuar

pothuajse 250 punonjës të drejtpërdrejt dhe më shumë se 200 të punësuar jo të drejtpërdrejt, duke qenë vazhdimisht ndër punëdhënësit kryesorë dhe tatim paguesit kryesorë në Kosovë.

Vlen të shënohet gjithashtu se deri në fund të vitit 2019 dhe duke ndjekur praktikën tona të përgjegjësisë shoqërore dhe të qëndrueshmërisë, ne kemi investuar tashmë rreth 7.3 milion euro për projekte të mbrojtjes së mjedisit, duke përmirësuar në mënyrë drastike ndikimin nga operacionet tona në përputhje me rrethanat, ndërsa kontributet tona për shoqërinë lokale të Hanit të Elezit tashmë arrijnë vlerën rreth 1.9 milion euro, duke përfshirë mbështetjen financiare direkte dhe indirekte, materializimin e projekteve në infrastrukturë si dhe në taksa komunale.

Për më tepër, transaksionet e shumta në prona, së bashku me aktivitetet tona të shtuara operationale, kanë krijuar të ardhura të vlefshme për individët dhe kompanitë lokale deri më tani, duke kontribuar kështu edhe më tej në ekonominë e komunës lokale dhe në mirëqenien e qytetarëve të saj. Për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm drejt rritjes së efektivitetit të performancës sonë shoqërore, janë ndërmarrë veprime të caktuara gjatë vitit 2019 brenda kornizës së strategjisë tonë për CSR dhe Qëndrueshmëri, si në vijim:

- Të nxitur nga orientimi ynë ndaj Dhjetë Parimeve të UNGC-së, jemi duke bashkëpunuar si në nivelin lokal ashtu edhe në atë global drejt arritjes së Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm për vitin 2030, në përputhje me angazhimin tonë në bazë të Kompaktit Global të OKB-së. Këtë vit, raporti ynë është siguruar dhe garantuar nga Kompania e Pavarur e Garantimit në Nivel të Avancuar për Komunikimin mbi Progresin, në përputhje me Kriteret e UNGC-së.
- Duke ndjekur iniciativën tonë për ta bërë organizatën tonë një vend më të mirë për të punuar, ne kemi lansuar një Anketë për Punonjësit e Grupit TITAN, duke ftuar të gjithë punonjësit të marrin pjesë dhe të japin komentet e tyre kthyes, duke i siguruar se të gjitha përgjigjet do të jenë anonime dhe do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

- Të përkushtuar në dhënien e mbështetjes materiale për iniciativat që mund të kontribuojnë në promovimin e aktiviteteve kulturore, ne i kemi dhuruar komunës një pjesë të pronës sonë, në mënyrë që të përdoret për ngritjen e një Qendre Rinore, gjithashtu duke ofruar ndihmë teknike gjatë fazës së ndërtimit.

Në përgjithësi, kërkohej disa hapa për të vendosur besimin e ndërsjellë midis bizneseve dhe palëve të interesit. Rruga më efektive drejt këtij qëllimi është përmes llogaridhënies shoqërore, rritjes së qëndrueshme, krijimit të përfitimeve të orientuara drejt njerëzve, si dhe bashkëpunimit të ngushtë me palët e interesuara, ku të gjithë duhet të bëjnë më të mirën e tyre për të mos vepruar si kundërshtarë dhe të jemi të rreshtuar në këtë përpjekje të kombinuar si partnerë mbështetës dhe kreativë.

Kjo sjellje kontribuon drejt një niveli të avancuar të zhvillimit shoqëror dhe ky është pikërisht qëndrimi që ndjekim, duke qenë gjithmonë të vendosur dhe të përkushtuar për të gëzuar besimin dhe lejen e shoqërisë për të vepruar.

Në përmbyllje të kësaj porositë, një referencë specifike i bëhet një ngjarjeje “pas bilancit”, që ka të bëjë me pandeminë e fundit dhe me masat e kujdesit që janë ndërmarrë në punë në mënyrë që të merreni me rreziqet përkatëse në Grupin TITAN në të gjithë botën si dhe në Sharrcem në nivelin lokal.

Në fillim të marsit 2020, për shkak të përhapjes së shpejtë të virusit COVID-19, në shumicën e vendeve janë vendosur masa rigorozë të distancës sociale, duke çrregulluar ekonominë globale dhe duke rezultuar në rënie të kërkesës. Nga shfaqja e krizës së koronavirusit, TITAN ka marrë masa për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e njerëzve tanë dhe për të siguruar vazhdimësinë operacionale dhe përmbushjen e nevojave të klientëve tanë.

Shëndeti dhe siguria e stafit, klientëve dhe furnizuesve tanë është prioritet kryesorë dhe janë marrë disa masa paraprake në këtë aspekt. Planet për vazhdimësinë e biznesit gjithashtu janë zbatuar dhe të gjitha fabrikat

tona të prodhimit të çimentos dhe aktivitetet tjera të integruara të biznesit mbeten funksionale.

Megjithëse ne ende nuk kemi parë ndonjë ndikim të rëndësishëm në operacionet tona dhe vëllimet e shitjeve të tremujorit të parë ishin në nivele normale, është e pashmangshme që derisa kriza COVID-19 po përhapet, ne gjithashtu do të prekemi në një periudhë afatshkurtër.

Sektorët e ndërtimtarisë dhe të materialeve të ndërtimit, në një periudhë afatshkurtër, janë më pak të ekspozuara ndaj kësaj krize, pasi sipas hulumtimit të Moody's, ata janë sektorë me “rrezik të ulët”, por, megjithatë, pritet gjithashtu të preken nga vëllimet e zvogëluara të shitjeve, veçanërisht në tremujorin e dytë.

Grupi Titan ka krijuar kontingjenca dhe fleksibilitet dhe ka forcuar pozicionin tonë të likuiditetit në katërqind (400) milion euro në kombinim të parave të gatshme dhe lehtësirave të kredive bankare.

Menaxhmenti i Grupit beson se, megjithëse COVID-19 mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në operacionet e Grupit në vitin 2020, një ndikim i tillë do të jetë i përballueshëm dhe Grupi mund ta përballojë këtë periudhë si dhe rënien e përkohshme në fitim.

Marrë parasysh atë që është thënë më lartë, Menaxhmenti i Sharrcemit mbetet vigjilent, dhe ne punojmë ngushtë me sektorin e Financave të Grupit dhe me funksionet tjera Korporative të Grupit TITAN për të hulumtuar strategjitë më të mira për të zvogëluar ndikimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e biznesit në të gjitha aspektet, përfshirë Qëndrueshmërinë e komuniteteve tona.

Ju faleminderit,

Thomas Glavas
Drejtor Menaxhues



PRANIA GLOBALE E TITANIT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE TË SHARRCEMIT

Sharrcem SH.P.K.
Adem Jashari 280
71510 Hani i Elezit
Kosovë
Tel. 00383 290 385 500
Fax. 00383 290 385 510
contact@sharrcem.com

Zyra Përfaqësuese në Prishtinë
Tringe Smajli 21
10000 Prishtinë
Kosovë
Tel. 00383 38 777 011


Emri i Sipërmarrjes së Përbashkët	Vendi	Fusha e Biznesit	Komenti
Sharr Beteiligungs GmbH (2)	Gjermani	Kompani Investuese	Sharrcem është 100% pronë e SHARR BETEILIGUNGS GmbH në Hamburg, Gjermani, e cila është anëtare e Grupit TITAN
Cement Plus LTD (2)	Kosovë	Kompani Tregtare	Pronë e Sharrcem SH.P.K.
Esha Material LLC (2)	Kosovë	Gurore dhe agregate	Pronë e Sharrcem SH.P.K.
Kosovo Construction Materials L.L.C. (2)	Kosovë	Gurore dhe agregate	Pronë e Sharrcem SH.P.K.

Ky raport i pavarur i garancisë së kufizuar lëshohet nga auditori i pavarur, Grant Thornton. Raporti është përfshirë në Raportin Vjetor të CSR dhe Qëndrueshmëria për vitin 2019 dhe është në dispozicion në uebfaqen tonë: www.sharrcem.com

Ju mund të hyni në linkun e Raportit për vitin 2019 duke skanuar kodin QR me pajisjen tuaj telefonike. Komentet tuaja kthehen në lidhje me performancën tonë të paraqitur në këtë Raport janë shumë të rëndësishme për ne pasi ne e konsiderojmë këtë Raport një mjet që na ndihmon për të kombinuar fokusin dhe interesat, dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në një rritje të përbashkët mes biznesit dhe shoqërisë.

Prania globale

Ne raportojmë për performancën dhe aktivitetet tona bazuar në katër rajonet tona gjeografike, dhe ndaras për sipërmarrjen tonë të përbashkët në Brazil.







1. PËRMBLEDHJE

RRETH SHARRCEMIT



Sharrcemi është një kompani me përvojë 84 vjeçare në industri dhe është blerë në vitin 2010 nga Grupi TITAN, një kompani me 117 vjet përvojë në industri dhe e nxitur nga angazhimi i saj për rritje të qëndrueshme, ajo ka përmirësuar ndjeshëm teknologjinë dhe teknikat e saj për prodhimin e lëndës së parë dhe çimentos dhe ka iniciuar zbatimin e standardeve të larta, të integruara në të gjitha nivelet e punës, ndërsa përgjegjësia sociale dhe praktikrat e qëndrueshmërisë mbeten ndër komponentët përbërës të punës dhe sjelljes sonë profesionale të përditshme, si iniciativa të inkorporuara në mënyrën se si e drejtojmë biznesin tonë.

Sharrcemi është anëtare e Këshillit të Investitorëve Evropian, Rrjetit CSR në Kosovë, Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe Odës Ekonomike të Kosovës.



PROCESI I TRANSFORMIMIT



Gatishmëria dhe dëshira e Grupit për investime kanë vazhduar në vitin 2019 në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve operacionale të Sharrcemit. Mjete financiare të konsiderueshme dhe resurse teknike u ndanë për të modernizuar linjën e prodhimit të çimentos dhe për makineritë përkatëse që nga dita e parë kur është blerë Sharrcemi nga Grupi TITAN, dhe kështu Sharrcemi është bërë kompania e parë në vend që ka siguruar Lejen e Integruar për Parandalim dhe Kontroll të Ndotjes - (IPPC). Kjo leje u krijua nga Bashkimi Evropian dhe është lëshuar nga Qeveria e Kosovës.

Gjithashtu, me krijimin e projektit Laboratori për Aktivitete të Biznesit - (LAB), i cili ofron mbështetje financiare dhe teknike në përpjekje për krijimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ne kemi qenë në gjendje të adresojmë disa nga çështjet më kritike që kanë rëndësi për komunitetin tonë.


Ne vazhdojmë të punojmë fuqishëm në mënyrë që të mbetemi kompani udhëheqëse për sa i përket mbajtjes së standardeve të larta në proceset e linjës së prodhimit, me investime të rëndësishme e të rregullta që bëhen në interes të shëndetit dhe sigurisë së punonjësve tanë, kontraktorëve dhe partnerëve të biznesit si dhe në mbrojtje të mjedisit.

HISTORIKU

1936	Është themeluar Fabrika e Çimentos SharrCem.
1972	Modernizimi i parë në fabrikë me një furrë rrotulluese dhe ftohës të furrës ka rritur kapacitetin e saj deri në 180,000 tonë në vit.
1980	Rritet kapaciteti i prodhimit pas investimeve të reja në furrën rrotulluese.
2000	Sharrcem përfshihet në planin shtetëror për privatizim dhe fillon periudha dhjetëvjeçare e qiradhënies.
2010	Grupi TITAN e blenë Sharrcemin dhe fillon një plan ambicioz i modernizimit për t'i plotësuar standardet ndërkombëtare në cilësi, teknologji dhe mbrojtje të mjedisit.
2011	Sharrcemi e merr rolin udhëheqës në krijimin e Rrjetit CSR në Kosovë dhe angazhohet për të bërë investime për modernizim të plotë.
2012	Sharrcem përfundon fazën e parë të modernizimit të teknologjisë dhe përmirëson efikasitetin e saj dhe ndikimin në mjedis. Fabrika siguron certifikimin e saj të parë për cilësi (ISO 9001) dhe zbaton Sistemin e Menaxhimit të Dioksidit të Karbonit. Kompania i shërben kryesisht tregut të Kosovës dhe bën shitje të herëpashershme në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.
2013	Sharrcemi certifikohet edhe me ISO 14001 – Sistem për Menaxhimin e Mjedisit dhe OHSAS ISO 18001 – Sistem për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Përveç certifikimeve, Sharrcem ka pranuar mirënjohje të rëndësishme për iniciativat e saj të CSR në vitin 2013. Kompania ka zbatuar sistemin e shpalosjes së emetimeve përmes ueb-portalit për ta informuar publikun dhe për të raportuar për aksidente dhe për CSR. Në aspektin e teknologjisë, është kryer Modernizimi i Procesit të Automatizimit si dhe është futur në përdorim Sistemi i Menaxhimit të Aseteve në Ndërmarrje. Publikimi i parë i Raportit të CSR-it dhe Auditimi për CSR janë kryer nga një organizatë e certifikuar.
2014	Sharrcem-i siguron lejen IPPC – e para e lëshuar në vend. Veç kësaj, Sharrcemi ka lansuar projektin Këshillin Botëror të Biznesit (World Business Council) / CSI (Iniciativa për Qëndrueshmëri në Industrinë e Çimentos) për inkorporimin e udhëzimeve të saj ndaj Kontraktuesve dhe në Sigurinë në Komunikacion. Në aspektin e Shëndetit dhe Sigurisë, kompania ka organizuar kursin e parë NEBOSH në Ballkan për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (duke mos e përfshirë Greqinë), i cili është mbajtur në Kosovë. Është kryer dizajni inovativ për automatizimin e punës së vinçit në hallën e klinkerit dhe ky inovacion ka eliminuar pozitat e rrezikshme në punë si dhe pluhurin si dhe janë ndërmarrë shumë Angazhime me Palët e Interesit për planin e saj ambicioz të investimeve me qëllim që vet ta bëjë prodhimin e derivateve. Është financuar LAB-i për të mundësuar vitin e parë të punës, duke përfshirë përkrahjen me burime të nevojshme administrative.

2015	Sharrcem implementon zgjidhje inovative në linjën e prodhimit, ndërsa nis punët e rehabilitimit të gurores dhe fillon me iniciativën për t'u certifikuar me SA 8000. Projekti LAB arrin frytet e para. 18 Agro ndërmarrje të vogla dhe të mesme vendosin me sukses produktet e tyre në treg. Grupi Titan i bashkohet Paktit për të Rinjtë në Bruksel dhe përfaqësuesit e Sharrcemit kanë pasur kënaqësinë të marrin pjesë në atë ngjarje.
2016	Sharrcem-i certifikohet edhe me standardin SA 8000. Ky standard përkrahë përgjegjësinë dhe llogaridhënien shoqërore duke siguruar implementimin e sistemeve të besueshme të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit dhe komunitetin. Këtë vit janë implementuar dy projekte. Është instaluar me sukses makina e re për ambalazhimin e paletave dhe puna ka filluar menjëherë duke përmirësuar shërbimet për klientë. Ndërkohë, Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza ka qenë një investim i madh që ka për synim përmirësimin e cilësisë së ujit të derdhur në mënyrë që të kujdesemi për mjedisin dhe shëndetin e punonjësve të Sharrcemit dhe komunitetit në afërsi. Në përpjekje për të ofruar siguri për punonjësit tanë, mirëqenie, si dhe për të aftësuar ata profesionalisht, është ofruar program i trajnimit nga VDZ përmes internetit për punonjësit në industrinë e çimentos, me anë të metodave të përziera të mësimi.
2017	Projekti ynë kryesor i Qëndrueshmërisë – LAB, ka siguruar dy grante: 1. Fuqizimi i Sektorit të Bujqësisë dhe Pemëtarisë në Han të Elezit – Granti është siguruar nga (USAID) për Zhvillim Bujqësor dhe Mundësi Rurale (AGRO) – projekti do ta zgjerojë mbështetjen për 15 biznese të reja. 2. Diversifikimi i Fermës në Përpunimin e Qumështit - Grant i siguruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) – një projekt që ka për qëllim diversifikimin e fermës dhe zhvillimin e biznesit. Nga investimet e bëra dhe nga performanca e lartë në punë e punonjësve tanë, rekordi më i lartë që nga viti 1936 është arritur gjatë këtij viti për sasinë e prodhimit të çimentos. Gjatë këtij viti raportues, Sharrcem është përzgjedhur si tatimpaguesi më i mirë në vend, si dhe Menaxheri ynë për Shëndet dhe Siguri ka qenë personi i parë i certifikuar nga Qeveria e Kosovës në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë.
2018	Punonjësit e Sharrcemit kanë përfituar nga platforma e re “unTe people” dhe nga lansimi i planit të veprimit për diversitet dhe përfshirje i lansuar nga Grupi në vitin 2018. Gjatë këtij viti raportues, Sharrcem ka marrë shumë çmime dhe mirënjohje nga institucione dhe OJQ të ndryshme për angazhimin e tij ndaj shëndetit dhe sigurisë, mjedisit dhe CSR.
2019	Sharrcem u ri-certifikua me certifikatën SA 8000 dhe kjo certifikatë vlen deri në prill 2022. Dy iniciativa të reja për të rinjtë u prezantuan gjithashtu: 1. Vlerësimi i tregut për mundësitë e punësimit, nga Sharrcemi përmes LAB-it, në bashkëpunim me Sektorin e Kontraktimit të Proceseve të Punës; dhe 2. Tokë e dhënë / dhuruar Komunës së Hanit të Elezit në mënyrë që të ndërtohet shtëpia e kulturës për të rinjtë. Si pjesë e përpjekjes sonë të vazhdueshme për të ofruar siguri, mirëqenie dhe aftësim profesional për stafin tonë, në vitin 2019 Sharrcemi organizoi trajnime për punonjësit e tij, përmes Institutit Austriak të Ekselencës. LAB, i cili është projekti ynë kryesor i CSR-it, u pranua gjithashtu si praktika më e mirë nga International Journal of World Economy. Sharrcemi mori një çmim për angazhim në aspektin e shëndetit dhe sigurisë gjatë javës evropiane për shëndetin dhe sigurinë në punë.

RRETH TITAN-it



Një përmbledhje për Grupin TITAN në një mjedis global të ndryshueshëm. Qasja e TITAN-it për krijimin e vlerës për palët e interesit dhe qeverisjen e korporatave.

MJEDISI GLOBAL I NDRYSHUESHËM

Në një mjedis global të shënuar me ndryshime të përshpejtuara, ne jemi duke monitoruar në mënyrë aktive dinamikat e reja të përshkruara më poshtë. Ne po i qendrojmë sfidës dhe po marrim pjesë, në bashkëpunim me palët tona të interesit, në përpjekjet për të adresuar në mënyrë efektive sfidat kryesore me të cilat përballet industria e çimentos sot.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I INFRASTRUKTURËS

Sipas Kombeve të Bashkuara, 68% e popullsisë botërore parashikohet të jetojë në zonat urbane deri në vitin 2050, krahasuar me shifrën aktuale prej 55%.

Zhvendosja e vazhdueshme e vendbanimit nga zonat rurale në ato urbane paraqet para shoqërisë sfidën e ngutshme për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për të akomoduar nevojat e njerëzve, duke përfshirë strehimin, transportin dhe sistemet e energjisë. Duke pasur parasysh sfida të tjera globale, të tilla si ndryshimi i klimës dhe shterimi i burimeve natyrore, zhvillimi urban nuk mund të ndodhë pa adresuar këto çështje serioze të qëndrueshmërisë. Shoqëria pret që të gjithë ata që janë përgjegjës për ndërtimin e botës së nesërme do të përgjigjen dhe do të luajnë rolin e tyre sot.

Përdorimi i çimentos pritet të shtohet dhe industria e çimentoskanjë rol të rëndësishëm, duke kontribuar përmes inovacionit në formësimin e qyteteve të qëndrueshme dhe të banueshme, në bashkëpunim me të gjitha palët relevante të interesit; autoritetet lokale, rregullatorët, komunitetet, partnerët e biznesit dhe klientët.

PRITSHMËRITË E SHTUARA TË SHOQËRISË LIDHUR ME QËNDRUESHMËRISË

Qëndrueshmëria po bëhet më e rëndësishme për të gjitha kompanitë e të gjitha industrive. Strategjia e qëndrueshmërisë është thelbësore për çdo kompani që kërkon të jetë konkurruese sot dhe të nxisë jetëgjatësinë e saj. Pas thirrjes për veprim sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të OKB-së për vitin 2030, një numër në rritje i ndërmarrjeve po i përafrojnë qëllimet e tyre me OZHQ-të dhe po matin, menaxhojnë dhe shpalojnë rreziqet dhe mundësitë e tyre të qëndrueshmërisë. Ajo që filloi si një premtim vullnetar po bëhet gradualisht i detyrueshëm, pasi investitorët po marrin parasysh çështjet e mjedisit, shoqërisë dhe qeverisjes (ESG) kur marrin vendime për investime, dhe shoqëria në përgjithësi ka pritshmëri më të mëdha ndaj sektori privat për angazhim dhe transparencë ndaj ESG-së. Me qëllim për të identifikuar ndikimin e saj potencialisht të lartë në ESG dhe për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet përkatëse, industria e çimentos ka prezantuar dhe po azhurnon vazhdimisht udhëzimet e qëndrueshmërisë, përmes Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA), ndërsa shumë kompani raportojnë performancën e tyre jo-financiare në përputhje me praktika globale dhe kombëtare. Nga ana tjetër, këto praktika gjithashtu evoluojnë për të adresuar kërkesat në rritje të palëve të interesit për transparencë dhe llogaridhënie.

QASJA E BIZNESIT

Duke u bazuar në përvojën 117 vjeçare në industri dhe të nxitur nga angazhimi i tij për rritje të qëndrueshme, TITANI është bërë një prodhues ndërkombëtar i çimentos dhe materialeve të ndërtimit, duke u shërbyer klientëve në më shumë se 25 tregje në të gjithë botën përmes një rrjeti prej 14 fabrikave të çimentos në 10 vende, si dhe me gurore, fabrika të betonit, terminale dhe objekte të tjera të prodhimit dhe shpërndarjes.

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (OZHQ-të)

Ndër 17 OZHQ-të për vitin 2030, TITANI ka identifikuar në vitin 2015 katër OZHQ si më të rëndësishme për biznesin tonë dhe tetë OZHQ si pika plotësuese për prioritetet tona kryesore, sipas tabelës më poshtë, dhe i kemi lidhur çështjet tona materiale të vitit 2015 dhe Objektivat e qëndrueshmërisë së vitit 2020 me shumicën e tyre. Ne e përcaktojmë kontributin e TITANIT për të gjitha OZHQ-të përmes Raportit të Integruar Vjetor të vitit 2019 dhe më në detaje në pasqyrat jo-financiare. Duke ndjekur rezultatet e vlerësimit të materialitetit në vitin 2019, ne punojmë në përcaktimin e objektivave për të gjitha çështjet materiale, në përputhje me OZHQ-të për vitin 2030.

OZHQ-të MË RELEVANTE PËR BIZNESIN TONË



OZHQ-të PLOTËSUESE PËR PRIRITETET TONA KRYESORE



VLERAT E GRUPIT TITAN

Vlerat e Grupit janë në thelbin e asaj që përfaqëson TITAN-i; ato drejtojnë strategjinë e TITAN-it dhe sigurojnë bazat për të gjitha operacionet e tij. Ato u kanë siguruar njerëzve të kësaj kompanie një lidhje të fortë dhe kanë mbështetur rritjen që ka ndihmuar TITAN-in për më shumë se një shekull, duke buruar drejtpërdrejt nga parimet, bindjet dhe vizioni i themeluesve të saj në vitin 1902. Ato mbeten bazë e fortë e kulturës dhe shpirtit familjar të TITAN-it.



INTEGRITETI

- Praktika etike në biznes
- Transparencë
- Komunikim i hapur



ARRITJA E REZULTATEVE

- Vlera e aksionarëve
- Objektiva të qarta
- Standarde të larta



NJOHURITË

- Rritja e bazës së njohurive
- Mjeshtëri në çdo funksion
- Përsosmëri në detyrat kryesore



PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM

- Organizim i të mësuarit
- Gatishmëria për ndryshim
- Ballafaqimi i suksesshëm me sfida



VLERA PËR KLIENTIN

- Parashikimi i nevojave të klientit
- Zgjidhje inovative
- Cilësi e lartë e produkteve dhe shërbimeve



PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE KORPORATIVE

- Siguria në rend të parë
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Angazhimi i palëve të interesit

!! Të rrënjosura në identitetin e Grupit dhe të ngulitura në kulturën e tij dhe në praktikën e njerëzve të tij, vlerat e TITAN-it e drejtojnë mënyrën sesi TITAN-i e kryen biznesin e tij - me respekt, llogaridhënie dhe përgjegjësi.

SHPËRNDARJA E VLERËS PËR TË GJITHË

Të frymëzuar nga kompania jonë amë për të shfrytëzuar, transformuar dhe shtuar burimet e kapitalit në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve dhe për të arritur rritje të qëndrueshme të biznesit, duke krijuar vlerë për të gjitha palët tona të interesit dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm, ne mbetemi të vendosur për të kontribuar në prosperitetin e vendit, duke bërë biznes bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të industrisë dhe duke ndërmarrë iniciativa dhe duke marrë përgjegjësi drejt nxitjes së një tregu të drejtë dhe transparent. Ne e konsiderojmë rritjen tonë të qëndrueshme vetëm kur shoqërohet me një zhvillim proporcional të komunitetit tonë dhe shoqërisë në përgjithësi.

VLERA E ZINXHIRIT

Aktivitetet biznesore të Sharrcemit kryhen ngavetëkompania, osenga filialet në pronësi të plotë të kompanisë. Këto aktivitete përfshijnë prodhimin, transportimin dhe shpërndarjen e çimentos, hirit të thatë dhe materialeve të lëndës së parë.

Në fabrikën tonë të çimentos në Han të Elezit, ne shtypim, bluajmë, ngrohim dhe ftohim lëndën e parë për të prodhuar klinker (zgjyrë), e cila më pas përpunohet më tej për të prodhuar çimento. Në dy guroret tona aktive (Dimcë dhe Paldenicë), ne nxjerrim lëndë të parë, siç është guri gëlqeror.

PJESA E FURNIZIMIT


Lënda e Parë



Furnizuesit




Fabrika/Prodhiimi



PJESA E SHPËRNDARJES

Shpërndarja



Klientët



CSR

Përgjegjësia shoqërore korporative është njëra nga vlerat e kompanisë amë dhe nënvizon angazhimin e saj të qëndrueshëm për t'u angazhuar me palët e interesit për një zhvillim të qëndrueshëm. Politika e CSR-it përqendrohet në kuptimin e çështjeve materiale për palët kryesore të interesit dhe shpërndarjen e vlerës për të gjithë, duke përdorur burimet e disponueshme, kështu që praktikatat e biznesit të Sharrcemit drejtohen dhe bazohen në vlerat dhe kodin e mirësjelljes së kompanisë TITAN.

FOKUSI NË SHARRCEM

A. PERFORMANCA FINANCIARE – PËRMBLEDHJE E SHIFRAVE KRYESORE

Qarkullimi	42,007,011 €
Totali i Aseteve	54,163,247 €
EBITDA	10,678,352 €
Fitimi (humbja) pas Tatimit	4,278,655 €
Shpenzimet Kapitale	1,502,954 €
Investimet në Mjedis si dhe në Shëndet dhe Siguri në Punë	245,405 €

B. PERFORMANCA JO-FINANCIARE

Angazhimi i Sharrcemit për të vepruar sipas vlerave të Grupit që nga fillimi ka dëshmuar se qëndrueshmëria mbetet njëra prej komponentëve më të rëndësishëm të mënyrës se si ne bëjmë biznes. Ne rregullisht bëjmë përpjekje për të gjetur mënyra të reja për të zvogëluar ndikimin në mjedis, duke përmirësuar kulturën tonë të sigurisë dhe duke përfshirë komunitetin. Ne mbetemi të përfshirë në iniciativat më të fundit për sa i përket qëndrueshmërisë, në të cilat TITAN është një anëtar aktiv.

Angazhimi dhe komunikimi me palët tona të interesit në një mënyrë të drejtpërdrejtë dhe transparente na ndihmuan të krijojmë vlera të përbashkëta dhe të kontribuojmë në një zhvillim të qëndrueshëm. Ne kujdesemi për punonjësit tanë dhe vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e tyre.

Ne mbrojmë të drejtat e njeriut, garantojmë kushte të mira të punës, dhe promovojmë sigurinë dhe shëndetin e njerëzve në fabrikë dhe në hapësirat e të gjitha aktiviteteve tona. Për më tepër hollësi për sa i përket shpalosjeve jo-financiare, shih Shtojcat sipas tabelave në vijim ku historiku tre vjeçar i të dhënave të konsoliduara (2017-2018-2019) lidhur me OZHQ-të (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) përkatëse për vitin 2030 paraqitet në mënyrë të standardizuar dhe përmbajtësore:


1. Indeksi i Performancës Mjedisore.
2. Indeksi i Performancës Sociale, i cili përfshinë si 'pikë kryesore' KPI-të e Performancës ndaj Sigurisë, KPI-të për Punësimin dhe zhvillimin e punonjësve, si dhe KPI-të për Përfshirjen e Palëve të Interesit.

MATERIALITETI DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

Përmes komunikimit të vazhdueshëm, ne qëndrojmë afër dhe të angazhuar me palët tona të interesit. Dëgjimi dhe dhënia e përgjigjeve ndaj shqetësimeve të tyre konsiderohet si një forcë shtytëse në përpjekjet tona për të përmbushur në mënyrë efektive sfidat e përgjegjësisë shoqërore korporative. Përveç kësaj, duke ndjekur parimet e përafrimit, rëndësisë dhe materialitetit, kompania jonë ka përfshirë punonjësit, komunitetet lokale, klientët, furnizuesit, shoqërinë civile dhe autoritetet qeveritare në listën e palëve kryesore të interesit. Janë iniciuar iniciative të ndryshme në bashkëpunim me palët tona të interesit për të arritur rritje të qëndrueshme.

BASHKËPUNIMI DHE PROCESI I PËRFSHIRJES

Në çdo moment, fazë, plan dhe strategji, bashkëpunimi me palët tona të interesit përfaqëson një element thelbësor të punës sonë të përditshëm, pasi ne e konsiderojmë bashkëpunimin e ngushtë dhe komunikimin me palët tona të interesit thelbësorë për të planifikuar dhe reaguar siç duhet. Ne gjithashtu vazhdojmë të përpiqemi të përmirësojmë organizimin tonë përmes zbatimit të sistemeve të certifikuara që mundësojnë gjurmimin dhe raportimin e performancës sonë të qëndrueshmërisë dhe ato janë të lidhura me vlerat dhe prioritetet tona për rritje të qëndrueshme. Procesi i angazhimit tonë me palët tona të interesit përfshin:



KJO TABELË PËRMBLEDHË REZULTATIN E DIALOGUT DHE TË PËRFSHIRJES SË PALËVE TË INTERESIT

PALËT KRYESORE TË INTERESIT	PROCESI I PËRFSHIRJES	ÇËSHTJET KRYESORE PËR GRUPIN E PALËS SË INTERSIT
Punonjësit - Sindikata	Anketa e opinionit të punonjësve 2019 Darkë me të gjithë punonjësit Marrëveshje kolektive Ngjarje të ndryshme për mirënjohje Politika e sinjalizuesve Mekanizmi i ankesave Linjat telefonike (Hotline) Ditët e komunikimit, etj.	CSR Shëndeti dhe Siguria në Punë; Përfshirja (komunikimi, pjesëmarrja, mirënjohja)
Klientët	Takime Dyer të hapura për vizita Intervista Studime Mekanizmi i ankesave	Bashkëpunimi i ngushtë Produkte dhe shërbime cilësore Ndërtim i qëndrueshëm
Kontraktuesit	Takime Dyert e hapura për vizita Letra informuese	Shëndeti dhe Siguria në Punë Bashkëpunimi i ngushtë Shkathtësitë dhe aftësitë
Komunitetet	Takime Ditët për komunitetet Intervista Studime Forume Punëtori	Shëndeti dhe Siguria Ndikimet në mjedisin lokal
Furnizuesit	Takime Intervista Vizita studimore Letra informuese	Bashkëpunimi i ngushtë Transparenca Rritja në të ardhmen
Autoritetet lokale	Programe Takime Intervistat Studime Ditët e hapura Forume dhe Punëtori	CSR - Mbështetje e komunitetit si dhe zhvillim / infrastrukturë Rritja në të ardhmen dhe punësimi

ÇËSHTJET MATERIALE TË IDENTIFIKUARA PËR SHARRCEMIN

ÇËSHTJET MATERIALE	PALËT E INTERESIT	VEPRIMET	OZHQ-TË
Varfëria dhe Papunësia	BE; Qeveria e Kosovës; Punonjësit; Kontraktorët; Komuna; CSR; OJQ-të	- Fushata Pakti për Rini - Laboratori për Aktivitete të Biznesit – LAB - BOPAL	   
Angazhimi në komunitet	Komuna; Punonjësit; Kontraktorët; Zinxhiri i Furnizimit; Bashkësia Islame; Mësuesit; LAB; Fëmijët; Gratë; AFS; IADK; REC	- Jave e Sigurisë në Vend - Uji i Pijshëm - Rritja e Vetëdijesimit përmes Edukimit për Mjedisin - Let's Do it Kosovo - SOS - Rroba për punëtorët teknik të Shkollave	  
Korrupsioni	BE; EIC; CSR; BB; BERZH; Ambasadat; IFC	CSR / EIC <-> SAA / NEDC	
Të drejtat e njeriut	Punonjësit; Kontraktorët; Komuna; Rrjeti CSR; UNDP; BB; BE; Ambasadat; IFC; Admin. e Qeverisë; OJQ-të	SA 8000	  
Qeverisja dhe Transparenca	Punonjësit; Kontraktorët; Komuna; Qev. e Kosovës; Rrjeti CSR; EIC;	- Takime për Angazhimin e Palëve të Interesit - Rrejtë CSR në Kosovë - Këshilli i Investitorëve Evropian (EIC)	 
Trajnimi dhe Zhvillimi i të Rinjve	Punonjësit; Studentët dhe Nxënësit; Komuna	- Fushata Pakti për Rini - Platforma e Drejtuesve të Titan-it - Zhvillimi i Njerëzve brenda Fabrikës - Trajnimet për Zhvillim Teknik - Arkitekturë (Frozen Music) - Kamping gjatë Vikendit për të Rinjtë	  
Menaxhimi Mjedisor	Punonjësit; Kontraktorët; Komuna; Policia Kufitare; Dogana; Klientët	- Zona të Gjelbra në Fabrikë - Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza - Monitorimi Sistemik i nivelit të akuiferit - Matja e Cilësisë së Ajrit - Mbyllja e Sallës së Klinkerit	 
Shfrytëzimi i Tokës	Punonjësit; Komuna; MMPH	Rehabilitimi i Gurores	
Ndryshimi Klimatik dhe Energjia	BERZH; Ambasada Franceze; Ambasada Gjermane; REC; CMZ	Strategjia për Ndryshimin Klimatik	 

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2020

Sharrcemkapërmirësuar më tej performancën e qëndrueshmërisë në vitin 2019, veçanërisht në fushat e: shëndetit dhe sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe punësimit, siç paraqitet në indeksin e KPI-ve për qëndrueshmërinë (shih SHTOJCËN “A”). Angazhimi ynë për përmirësim të vazhdueshëm në lidhje me ndikimet në nivelin lokal, dhe angazhimi ynë i vazhdueshëm me palët tona kryesore të interesit me anë të iniciativave dhe veprimeve specifike që kanë për qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve lokale janë elemente thelbësore të strategjisë sonë të biznesit. Sipas kësaj kornize, Sharrcemi ka arritur shumicën e synimeve të tij me horizontin 2020, për performancën mjedisore dhe shoqërore, duke kontribuar kështu pozitivisht në arritjen e synimeve përkatëse të Grupit TITAN për vitin 2020. Parashikimi për të ardhmen: Një proces i ri i përcaktimit të synimeve është duke u zhvilluar në vitin 2020 në nivelin e Grupit dhe gjithashtu në nivelin e Njesisë Biznesore, për angazhimin ndaj synimeve të reja për qëndrueshmëri sipas horizontit 2025. Një nga fushat kryesore të Sharrcemit për performancë të qëndrueshme është kontributi në qëndrueshmërinë e komuniteteve tona. Në këtë aspekt, dhe siç është botuar në IAR 2019 të Grupit TITAN - (faqe 78): Në vitin 2019, ne vazhduam të analizojmë ndikimin tonë në nivelin lokal dhe ne zgjeruam metodologjinë e ofruar nga UNCTAD për të vlerësuar shpenzimet në nivelin lokal. Duke vendosur kriteret e përafuara me modelin tonë të biznesit dhe strategjinë e qëndrueshmërisë për të inkurajuar përqendrimin tek çështjet materiale në iniciativat tona të përfshirjes së komunitetit, ne lansuam një platformë të re të bazuar në internet për vlerësimin e të gjitha veprimeve që janë ndërmarrë pas informatave kthyesë (feedback) të palëve të interesit. Sharrcemi do të marrë pjesë aktivisht në vlerësimin e iniciativave dhe veprimeve të Njesisë sonë Biznesore (BU) për përfshirjen e komunitetit në vitin 2020, duke kontribuar sipas platformës së Grupit, i cili është një modul të ri i sistemit për mbledhjen e të dhënave të Grupit (CSR Databank e Grupit TITAN).

VLERËSIMI I RI I MATERIALITETIT

TITAN-i ka hapur një cikël të ri të vlerësimit të materialitetit në nivelin e Grupit në mënyrë që të përfshijë pikëpamjet e fundit të palëve të interesit në planifikimin tonë strategjik dhe ne do të botojmë matricën tonë të re të materialitetit dhe objektivat e qëndrueshmërisë në vitin 2020. Prioriteti kryesor i TITAN-it është zvogëlimi i emetimit të karbonit në punën tonë si dhe pjesëmarrja jonë në de-karbonizimin e zinxhirit të vlerës së ndërtimit, duke kontribuar në përpjekjen globale për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Grupi pret të përmbushë objektivin e tij të vitit 2020 për një ulje prej 20% të emetimeve specifike krahasuar me vitin bazë 1990 me një vonesë të shkurtër, për shkak të kushteve rregullative dhe të tregut që ndikojnë në produkt dhe përzierje të karburantit. Për më tepër, TITAN-i vazhdon të investojë në vendosjen e bazave për sukses afatgjatë: zvogëlimin e rreziqeve dhe shfrytëzimin e mundësive që krijojnë ndryshimet klimatike për biznesin tonë, duke përfituar nga mundësitë e ofruara nga revolucioni digjital, dhe duke vazhduar që ta ndërtojmë traditën tonë të gjatë të angazhimit të palëve të interesit. Sharrcemi do të hapë ciklin e ri të vlerësimit të materialitetit në nivelin e Njesisë së Biznesit (BU) në vitin 2020 dhe rezultatet për çështjet kryesore materiale do të paraqiten në Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë së Sharrcemit për vitin 2020. Sharrcemi pranon që kushtet në lidhje me identifikimin dhe prioritetimin e çështjeve materiale për palët e brendshme dhe të jashtme të interesit u ndryshuan që nga cikli i mëparshëm i Vlerësimit të Materialitetit në Njësinë tonë Biznesore në vitin 2016. Kushtet e reja përfshijnë ndikimet në shëndetin publik për shkak të pandemisë së COVID-19 në vitin 2020. Në vitin 2019, vendimi i Grupit TITAN ishte që të hape një cikël të ri të vlerësimit të materialitetit, rezultatet e të cilit do të paraqiten në Raportin Vjetor të Integruar të Grupit TITAN për vitin 2020.

QEVERISJA KORPORATIVE DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

Përmes qeverisjes së duhur korporative, TITAN-i synon të sigurojë që çdo vendim i menaxhmentit të jetë në përputhje me qëllimin dhe vlerat tona thelbësore, të marrë parasysh çështjet e qëndrueshmërisë dhe të jetë në interesin më të mirë të palëve të interesit. Duke identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë aktive të gjitha rreziqet dhe mundësitë e tij me rëndësi potenciale, TITAN-i është në gjendje të përgatitet për çështje që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit të tij dhe të arrijë objektivat e tij strategjike.

QEVERISJA DHE TRANSPARENCA BRENDA SHARRCEM

Gjatë vitit të kaluar, kompania jonë bëri shumë përpjekje në përmirësimin e kornizës për shpalosjen e të gjitha KPI-ve, siç ishte rasti në vitin 2019 – përkatësisht për Performancën Mjedisore dhe Sociale duke prezantuar Sistemin e Indeksit të KPI-ve, (shih SHTOJCËN “B”). Ky raport gjithashtu përfshin një Indeks të shpalosjeve për sa i përket zbatimit të Dhjetë Parimeve të UNGC-së nga Sharrcemi (shih SHTOJCËN “C”), gjithashtu duke iu referuar në mënyrë të qartë Indeksit të KPI-ve në Raport. Përmes qeverisjes së duhur korporative, TITAN-i synon të sigurojë që çdo vendim i menaxhmentit të jetë në përputhje me qëllimin dhe vlerat tona thelbësore, të marrë parasysh çështjet e qëndrueshmërisë dhe të jetë në interesin më të mirë të palëve të interesit.

Ekziston një komision disiplinor në Sharrcem. Komisioni punon sipas parimit të shkruar në lidhje me çdo lloj shkelje, incident ose keqpërdorim të përgjegjësive/detyrave të punës, etj. Në rast se dikush ka një çështje për të raportuar, ai/ajo duhet të plotësojë formularin përkatës dhe t’ia adresojë komisionit, dhe komisioni do të shqyrtojë çështjen, do të propozojë masat e nevojshme disiplinore dhe do t’ia paraqes Bordit të Drejtorëve për vendimin përfundimtar.

ZBATUESHMËRIA DHE KUJDESI I DUHUR

Komiteti Ekzekutiv i Grupit TITAN është përgjegjës për përcaktimin e politikave të Grupit dhe të sigurojnë që ato të zbatohen në të gjithë Grupin. Paralelisht, programet e etikës dhe pajtueshmërisë të zbatuara në tërë operacionet e TITAN-it sigurojnë që parimet dhe vlerat e Grupit janë të integruara në punët e përditshme dhe kultura e menaxhimit të rrezikut të përforcohet në të gjithë Grupin TITAN. Efektiviteti i sistemeve dhe politikave të zbatuara në Grup dhe në nivelin e njësisë së biznesit rishikohet sistematikisht nga Komiteti Ekzekutiv i Grupit TITAN dhe nga menaxhmenti i njësive të biznesit, përfshirë aspektin e pajtueshmërisë me standardet përkatëse të Grupit.

Të gjitha proceset e pajtueshmërisë mbikëqyren nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm i Grupit TITAN, duke marrë përsipër, përveç auditimit të brendshëm, edhe përgjegjësinë për rrezikun dhe pajtueshmërinë. Auditimi i Brendshëm i Grupit TITAN është një departament i pavarur që raporton drejtpërdrejt në Komitetin e Auditimit dhe Rrezikut. Fusha e përgjegjësisë të Auditimit të Brendshëm gjithashtu përfshin:

- Monitorimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë me rregulloren e brendshme të kompanisë, kodin e mirësjelljes dhe ligjet në fuqi në të gjitha juridiksionet në të cilat vepron Grupi.
- Ofrimin e shërbimeve këshilluese (p.sh. rishikimi i procedurave të reja, rishikimet e sistemeve të reja të Teknologjisë Informative pas implementimit).
- Ndërmarrjen e detyrave të veçanta (p.sh. hetimet për mashtrim).

Një element shtesë i qasjes së integruar të Grupit TITAN dhe i praktikave të vendosura në Sharrcem, janë përpjekjet e vazhdueshme për të regjistruar, vlerësuar dhe raportuar para audiencës së gjerë, incidentet dhe ndëshkimet përkatëse dhe gjobat në fushat e:

- Ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me të drejtat e njeriut (përfshirë shkeljet e rregulloreve për Shëndetin dhe Sigurinë, si dhe Ligjet dhe Rregulloret tjera për të Drejtat e Njeriut dhe Anti-korrupsionin)
- Ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me mjedisin.
- Ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me furnizimin me produkte dhe shërbime.

Veç kësaj, një arritje tjetër thelbësore që vlen të përmendet në këtë raport është sigurimi i Standardit Ndërkombëtar të Llogaridhënies Shoqërore - SA 8000 nga Sharrcemi, si pjesë e angazhimit të tij për t'u menaxhuar sipas sistemeve të certifikuara, duke vendosur kështu transparencën dhe raportimin në praktikë. Në vitin 2019, kompania iu nënshtrua auditimit dhe ricertifikimit që shënon vendosmërinë tonë për të funksionuar dhe raportuar si një fqinj i mirë në mesin e kolegëve tanë, brenda organizatës dhe jashtë saj, gjatë gjithë kohës duke respektuar kushtet e barazisë dhe paanësisë. Asnjë incident, gjobitje ose ndëshkim tjetër në lidhje me të drejtat e njeriut dhe korrupsionin ose veprime ligjore për sjellje anti-konkurruese, shkelje të praktikave të anti-trustit ose anti-monopolit, nuk janë regjistruar në Sharrcem gjatë vitit 2019.

KODI I MIRËSJELLES I GRUPIT TITANIT

Në përmbushjen e objektivave të biznesit, Sharrcemi zbaton me ndërgjegje parimet e tij etike të cilat gjenden në kodin e mirësjelljes së kompanisë. Dokumenti merret me çështje etike dhe ofron udhëzime të cilat përcaktojnë parimet tona të funksionimit. Kjo siguron që punonjësit tanë t'i njohin standardet më të larta të zbatuara nga kompania për mënyrën se si bëjmë biznes. Kjo përfshinë zbatimin

rigoroz të ligjeve, të drejtave të njeriut, konventave ndërkombëtare që luftojnë korrupsionin, mbrojtjen e informacionit konfidencial, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe marrëdhëniet me bashkëpunëtorët kryesorë.


Në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar komunikimin e hapur dhe të ndershëm të Sharrcemit në të gjitha nivelet, është krijuar mekanizmi i ankesave për raportimin e shkeljeve të kodit të mirësjelljes, dhe është krijuar adresa elektronike në vijim: complains@sharrcem.com të cilën punonjësit mund ta përdorin për të dërguar ndonjë koment, pyetje dhe sugjerim në lidhje me kodin e mirësjelljes dhe çdo shkelje të parimeve etike brenda kompanisë. Asnjë hetim ose raportim i shkeljes së kodit të mirësjelljes nuk u raportua brenda periudhës të cilën e përfshinë ky Raport. Sharrcemi monitoron një larmi çështjesh të lidhura me të drejtat e njeriut, të tilla si barazia gjinore dhe pjesëmarrja në Sindikatë. KPI-të përkatëse janë paraqitur në më shumë hollësi në kuadër të Indeksit të Performancës Shoqërore, shih SHTOJCËN "A".

VENDOSJA E QËNDRUESHMËRISË

Qëndrueshmëria është një prioritet i lartë për Sharrcemin dhe është ngulitur fuqishëm në strategjinë tonë përmes rishikimit të rregullt të të gjitha çështjeve të materialitetit për palët tona të interesit, në përcaktimit e veprimeve dhe caqeve të përshtatshme dhe në zbatimit e politikave përkatëse mjedisore dhe shoqërore. Politika e CSR-it synon të ngulisë qëndrueshmërinë në organizatë, ndërsa në të njëjtën kohë mbështet një ekuilibër më të mirë mes interesave afatshkurtra dhe afatgjate, duke përshtatur politikat dhe praktikat me nevojat dhe prioritetet e tregut lokal në mënyrë që të përçojë qëndrueshmërinë në të gjithë zinxhirin e vlerës. Ne përpiqemi të përmirësojmë kompaninë tonë edhe përmes zbatimit të sistemeve të certifikuara që mundësojnë monitorimin dhe raportimin e performancës sonë për sa i përket qëndrueshmërisë.

STRUKTURA E SHARRCEMIT PËR QEVERISJE TË QËNDRUESHME

BORDI I DREJTORËVE




BORDET, KOMISIONET/KËSHILLAT TJERË NË SHARRCEM



NE BËJMË PËRPPJEKJE TË ZBATOJMË PIKAT NË VIJIM:

- Zbatimi i strukturës së krijuar për CSR.
- Zbatimi i politikave dhe procedurave të krijuara për CSR.
- Kujdesi për njerëzit, shoqërinë dhe mjedisin.
- Mbajtja e komunikimit me punonjësit dhe palët tjera relevante të interesit.
- Lehtësimi dhe monitorimi i angazhimit me komunitetin.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMITETIT PËR CSR



PRIORITITET

- Angazhim i vazhdueshëm me palët e interesit.
- Shpalosja dhe transparenca.
- Kontraktorët: takime dhe trajnime për zbatimin e udhëzimeve për CSI.
- Fokusi në çështjet materiale të komunitetit, fuqizimi i bordit këshillëdhënës lokal të pavarur - BOPAL.
- Mbështetje e fuqishme dhe e vazhdueshme për projektin LAB.
- Trajnime dhe përmirësime të vazhdueshme.
- Zhvillimi i punonjësve dhe përshtatja me udhëzimet e CSI-së.
- Përmbushja e standardeve të larta të qëndrueshmërisë përmes sistemeve të certifikuara.
- Mbështetja dhe kontributi për Rrjeti CSR Kosova.
- Ngritja e vazhdueshme e vetëdijesimit për CSR brenda kompanisë, komunitetit dhe përtej.
- Kontributi në edukim në nivel lokal dhe kombëtar.
- Pakti për Rini: evente dhe ngritja e vetëdijesimit.
- Institucionet NDËRKOMBËTARE: bashkëpunimi i vazhdueshëm.
- SA 8000, trajnimet e vazhdueshme dhe ngritja e vetëdijesimit.



VLERËSIMI I RREZIKUT NGA COVID-19

Në fillim të marsit 2020, për shkak të përhapjes së shpejtë të virusit COVID-19, në shumicën e vendeve janë vendosur masa rigoroze të distancës sociale, duke çrregulluar ekonominë globale dhe duke rezultuar në rënie të kërkesës. Nga shfaqja e krizës së koronavirusit, TITAN ka marrë masa për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e njerëzve tanë dhe për të siguruar vazhdimësinë operacionale dhe përmbushjen e nevojave të klientëve tanë. Shëndeti dhe siguria e stafit, klientëve dhe furnizuesve tanë është prioritet kryesorë dhe janë marrë disa masa paraprake në këtë aspekt. Planet për vazhdimësinë e biznesit gjithashtu janë zbatuar dhe të gjitha fabrikat tona të prodhimit të çimentos dhe aktivitetet tjera të integruara të biznesit mbeten funksionale.

Megjithëse ne ende nuk kemi parë ndonjë ndikim të rëndësishëm në operacionet tona dhe vëllimet e shitjeve në tremujorin e parë ishin në nivele normale, është e pashmangshme që derisa kriza COVID-19 po përhapet, ne gjithashtu do të prekemi në një periudhë afatshkurtër.

Sektorët e ndërtimtarisë dhe të materialeve të ndërtimit, në një periudhë afatshkurtër, janë më pak të ekspozuar ndaj kësaj krize, pasi sipas hulumtimit të Moody's, ata janë sektorë me “rrezik të ulët”, por, megjithatë, pritet gjithashtu të preken nga vëllimet e zvogëluara të shitjeve, veçanërisht në tremujorin e dytë. Grupi TITAN ka krijuar kontingjenca dhe fleksibilitet dhe ka forcuar pozicionin tonë të likuiditetit në katërqind (400) milion euro në kombinim të parave të gatshme dhe lehtësirave të kredive bankare. Menaxhmenti i Grupit beson se, megjithëse COVID-19 mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në operacionet e Grupit në vitin 2020, një ndikim i tillë do të jetë i përballueshëm dhe Grupi mund ta përballojë këtë periudhë si dhe rënien e përkohshme në fitim.

Marrë parasysh atë që është thënë më lartë, Menaxhmenti i Sharrcemit mbetet vigjilent, dhe ne punojmë ngushtë me sektorin e Financave të Grupit dhe me funksionet tjera Korporative të Grupit TITAN për të hulumtuar strategjitë më të mira për të zbutur ndikimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e biznesit në të gjitha aspektet, përfshirë Qëndrueshmërinë e komuniteteve tona.

QËNDRUESHMËRIA PËRMES SISTEMEVE TË CERTIFIKUARA

Kompania jonë vazhdon të jetë e përkushtuar në sigurimin e kushteve adekuate të punës, në të gjitha aspektet dhe për të gjitha palët. Prandaj, si rezultat i këtij angazhimi, Sharrcemi ka vendosur dhe zbaton Sisteme Ndërkombëtare dhe Evropiane të Menaxhimit të Certifikuar dhe gjithashtu ka siguruar Lejen e parë IPPC (Ndalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes) të lëshuar në vend. Veç kësaj, Sharrcemi u bë kompania e parë që ka siguruar

Certifikimin nga Eurocert për Standardin SA 8000, dhe është ri-certifikuar gjatë vitit raportues.

Ne mbetemi të vendosur për të kontribuar në prosperitetin e vendit, jo vetëm duke bërë biznes bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të industrisë, por gjithashtu duke ndërmarrë iniciativa të ndryshme dhe duke marrë përgjegjësi drejt nxitjes së një tregu të drejtë dhe transparent.

PIKA	SISTEMI I MENAXHIMIT/ CERTIFIKIMIT	STATUSI
Të gjitha produktet/ llojet e çimentos	CEM IV/B (P-W) 32.5R	EN 197- 1:2000
	CEM II/B-M (W-L) 42.5R	
	CEM I 52.5N	
	MC 5 Sharrmall	
Ndikimi në CO ₂	Menaxhimi i Sistemit të CO ₂	Inkorporuar në EMS ISO 14001
Mjedisi	Sistemi i Menaxhimi të Ujit	Inkorporuar në EMS ISO 14001
Mjedisi	ISO 14001	✓ 
Mjedisi	IPPC – Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes	✓ IPPC
Cilësia	ISO 9001	✓ 
Siguria	OHSAS 18001	✓ 
Llogaridhënia	Llogaridhënia Shoqërore SA 8000	✓ 
Financat	Auditimi i kryer në mes të vitit	✓
Grant Thornton	Auditimi	✓



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRENJENIES SOCIALE



REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING



PRODUKTET DHE PARTNERËT NË BIZNES



Çdo biznes përmes zinxhirëve dhe rrjeteve të tij të furnizimit mund të udhëheq rrugën drejt sjelljes së përgjegjshme në shoqëri dhe kjo është një domosdoshmëri për zhvillimin dhe rritjen e biznesit. Klientët, furnizuesit dhe kontraktorët tanë konsiderohen të jenë një pjesë thelbësore dhe e drejtpërdrejtë e gjenerimit të aktivitetit tonë biznesor. Prandaj, Sharrcepi ka miratuar dhe zbaton vazhdimisht një politikë të qartë përmes procedurave të saj të prokurimit dhe rekrutimit duke i dhënë përparësi faktorit lokal në aspektin e konkurrencës, duke zbatuar Sistemet e Certifikuara Ndërkombëtare dhe Evropiane në Menaxhim. Ne vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje të konsiderueshme njerëzve, shoqërisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

KLIENTËT

Sharrcepi ka krijuar një pozitë në tregun e vendit përmes produktit të tij me cilësi të lartë dhe qasje profesionale ndaj klientëve

dhe kjo është arritur përmes investimeve të mëdha të bëra në teknologji dhe në burime njerëzore. Investime të shumta u bënë gjithashtu në projekte të ndryshme duke rezultuar në një ndikim pozitiv në optimizimin e procesit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit si dhe në sigurinë në punë. Për më tepër, niveli i kujdesit të ofruar për punonjësit tanë ofrohet edhe për klientët tanë.

Klientët janë të regjistruar si duhet dhe të pajisur me të gjitha klauzolat e sigurisë dhe të qasjes të cilat janë obligative nga kompania. Ekziston një komunikim dhe bashkëpunim i rregullt për të zhvilluar mekanizmat më të mirë dhe për të siguruar që jemi në përputhje me standardet më të larta. Në bashkëpunim me klientët tanë, Sharrcepi ishte pjesë e projektit të autostradës që lidh Prishtinën dhe Shkupin dhe kjo autostradë ka shumë mbikalime dhe nënkalime. Për shkak të punës cilësore dhe suksesit të vazhdueshëm, Sharrcepi ka

qenë një faktor i rëndësishëm i këtij projekti të madh. Mund të themi me krenari se çimentoja e Sharrcemit është përdorur për ndërtimin e secilës urë. Segmenti i fundit i autostradës ka një rën prej urave më të gjata në Kosovë, si dhe në rajon. Lidhur me prodhimin e betonit, i cili përbën një element thelbësor në punët e ndërtimtarisë, janë kryer analiza paraprake të hollësishme për të përzgjedhur kualitetin e duhur të produkteve të përdorura. Për një projekt të kësaj madhësie, është dashur të përdorej lloji më i mirë i çimentos, siç janë llojet e çimentos së Sharrcem-it CEM I 52.5 dhe CEM II 42.5. Deri më sot, mijëra kub beton janë prodhuar nga çimentoja e Sharrcemit dhe janë përdorur për ndërtimin e urës më të gjatë në rajon, përkatësisht me gjatësi 5.7 km e cila do të lidh Kosovën me shtetet e rajonit dhe pjesën tjetër të botës. Në 3 vitet e fundit, kompania jonë vazhdoi të jetë një faktor i rëndësishëm për projektin e madh të Qeverisë së Kosovës për infrastrukturë – siç janë autostrada dhe ura.

Shpresojmë që ndërtimi i llojit të kësaj autostrate të ndihmojë në adresimin e çështjeve të shoqërisë pasi kjo autostradë do të lidhë vendin tonë me vendet e rajonit dhe

do të sigurojë qasje rrugore me pjesën tjetër të botës dhe kjo përbën rëndësi shumë të madhe për ekonominë e vendit duke lidhur prodhuesit me tregje, ofron mundësi për punë, etj. - me një fjalë, rrugët janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e çdo vendi. Ne vazhdojmë të jemi të përkushtuar për të: punuar ngushtë me klientët tanë dhe duke siguruar furnizimin e duhur, duke mbajtur ngjarje të ndryshme për komunikim dhe duke ofruar pyetësorë në lidhje me kënaqësinë e klientëve dhe shërbimin e mbështetjes teknike, duke planifikuar trajnime të rregullta shëndetësore dhe të sigurisë dhe duke marrë pjesë në fushatën të CSI-së për vozitje.

NGJARJET ME KLIENTË

Festimi i suksesit vjetor është mbajtur edhe me klientët në fund të vitit. Njësoj si vitet e mëparshme, i kemi kujtuar të gjitha ndërveprimet dhe angazhimet që kanë ndodhur brenda vitit kalendarik. Njësoj si vitet e mëparshme, i kemi kujtuar të gjitha ndërveprimet dhe angazhimet që kanë ndodhur brenda vitit kalendarik. Lloje të ndryshme angazhimesh janë zhvilluar edhe këtë vit, duke përfshirë vozitjen për



CSI, trajtimin e llojeve të ndryshme të ankesave dhe kërkesave, takime individuale, vizita në hapësirat e klientëve dhe shumë ndërveprime të tjera, por këto lloj takimesh dhe festimesh me klientët tanë vazhdojnë të jenë një traditë e vlerësuar nga Sharrcemi.

PYETËSOR PËR SA I PËR KËNAQËSISË SË KLIENTËVE

Pyetëtori mbi kënaqësinë e klientëve ka ndihmuar vazhdimisht kompaninë për të kuptuar nevojat e klientëve. Së bashku me përkushtimin e kompanisë për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, pyetëtori mbetet një nga çështjet kyçe për të kuptuar nevojat e klientëve tanë, duke rritur kështu bashkëpunimin tonë me ta. Përmes pyetëorit, mund të gjejmë mënyra se si mund të përmirësohemi për sa i përket cilësisë së produkteve, cilësisë së paketimit dhe sigurisht duke lehtësuar dhe duke i bërë më praktike proceset e ngarkimit dhe shkarkimit brenda fabrikës, gjithnjë duke pasur parasysh vlerën e kohës së tyre. Klientët tanë janë palët tona më të rëndësishme të interesit dhe e kanë vendin në thelbin e vërtetë të biznesit tonë. Prandaj, ne do të vazhdojmë në të ardhmen

të administrojmë pyetësorin në fjalë, pasi ai siguron jo vetëm mënyra për ndërveprim dhe këmbim mendimesh, por është një mjet që mund të na ndihmojë për të kombinuar fokusin dhe interesat, duke kontribuar kështu në mënyrë efektive në një zhvillim të përbashkët.

KONTRIBUTI DHE NDARJA E NJOHURIVE NË KUADËR TË RRJETIT

Sharrcemi ka qenë gjithnjë i angazhuar në mbështetje të iniciativave të ndryshme të Rrjetit CSR Kosova për të rinjtë dhe qëndrueshmëri. Dy ngjarje të ndryshme janë mbajtur gjatë vitit me qëllim për të bërë bashkë bizneset që veprojnë në Kosovë për të kontribuar për OZHQ-të, për të mbështetur ndërmarrjet e reja dhe për të investuar në të rinjtë dhe mundësitë vullnetare, por gjithashtu për të investuar edhe në mbrojtjen e mjedisit. Përveç kontributit financiar, është e rëndësishme të theksohet se kompania jonë kontribuoi duke ndarë njohuritë dhe përvojën e saj dhe duke u përfshirë drejtpërdrejt në OZHQ-të.





The background image shows an industrial scene. On the left, a tall, dark, cylindrical chimney rises into a clear blue sky. To its right, a large, light-colored industrial building is visible, featuring a sign that reads 'SHARRCEM'. In the foreground, there are green trees and a grassy area. A teal-colored curved graphic element is located in the bottom-left corner of the image.

2. KAPITALI NJERËZOR DHE SOCIAL

SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Gjithmonë mund të bëhet më shumë në fushën e shëndetit dhe sigurisë, kështu që organizata jonë rregullisht investon në përmirësimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke e konsideruar atë një prioritet kryesor të biznesit si brenda fabrikës ashtu edhe në aktivitetet e jashtme. Përveç përmbushjes së të gjitha detyrimeve ligjore të identifikuar në lidhje me shëndetin dhe sigurinë, adresimin e tyre në mënyrë të kënaqshme dhe përcaktimin e të gjitha funksioneve të nevojshme të shëndetit dhe sigurisë në punë të kërkuara nga legjislacioni kombëtar dhe lokal, ndërmerren iniciativa të tjera të shumta në lidhje me qëllimin kryesor për të krijuar një kulturë jetese në lidhje me sigurinë në punë.

Kompania gjithashtu angazhohet në mënyrë të konsiderueshme në përpjekjet për ngritjen e vetëdijes për ruajtjen më të mirë të shëndetit dhe sigurisë në punë për të gjithë punonjësit tanë të drejtpërdrejtë dhe kontraktorët e përfshirë në të gjitha aktivitetet. Menaxhmenti i Sharrcemit është i vetëdijshëm se kjo përfaqëson një përpjekje të pafund dhe përpiqet të mbetet vigjilent dhe të përmirësojë vazhdimisht performancën e kompanisë në këtë aspekt. Masat e shëndetit dhe sigurisë që duhet të zbatohen për punonjësit, kontraktorët, furnizuesit dhe / ose komunitetin lokal mbeten një prioritet i lartë në agjendën tonë ditore. Për më shumë detaje, ju lutemi referojuni SHTOJCARE nën KPI-të për Indeksin e Performancës Sociale me të dhënat e konsoliduara për tri vitet e fundit (2017- 2019).

Në vitin 2019, ne kemi parë shenja inkurajuese në treguesit tanë të performancës për sa i përket shëndetit dhe sigurisë, ku tendencat tregojnë përmirësim të qëndrueshëm. Brenda vitit nuk është shënuar asnjë vdekje dhe kohë e humbur në punë nga lëndimi (LTI) dhe ka pasur progres shumë të mirë në zbatimin e sistemeve dhe udhëzimeve të reja. Përveç kësaj, janë kryer trajnime dhe auditime të nevojshme.

- Sharrcemi u auditua nga Departamenti i Grupit SHSM dhe u inspektua nga Drejtori Rajonal për Shëndet dhe Siguri.
- Një auditim i brendshëm për të raportuar për mjedisin si dhe shëndetin dhe sigurinë u krye nga Menaxheri i Auditimit, Evropa Juglindore dhe Turqia / Auditimi i Brendshëm i Grupit.
- Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë u ri-certifikua nga Eurocert.
- Sharrcemi mbetet i përkushtuar për të rritur standardet në të gjithë Njësine Biznesore.
- Regjistri i legjislacionit për shëndet dhe siguri vazhdon të monitorohet dhe rishikohet për të siguruar që Njësia Biznesore është duke përmbushur obligimet e saja statutores.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi mes stafit është nxitur nga Këshilli i BL-së, i Njesisë Biznesore dhe Këshilli për Shëndet dhe Siguri.
- Kontrolli ndaj rrezikut arrihet përmes veprimit të koordinuar nga të gjitha Departamentet e Njesisë Biznesore (BU).
- Duhet të rrisim garancinë që klientët dhe kontraktorët me të cilët punojmë, të zbatojnë të gjitha kërkesat përkatëse për shëndet dhe siguri.

VEPRIMET KRYESORE

Krijimi i proceseve për menaxhimin e sigurisë (Leja për Punë (PtW) dhe procedura e certifikimit Lock Out, Tag Out, Try Out (LOTOTO)), rritja e vetëdijesimit për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, përmirësimi i komunikimit lidhur me objektivat dhe programet për shëndetin dhe sigurinë, trajnimi dhe vetëdijesimi, matja dhe monitorimi i performancës, jokonformitetet, veprimet korrigjuese dhe parandaluese, kërkesat ligjore dhe të tjera, kontrolli operacional, reagimi ndaj emergjencave.

EKIPI I EMERGJENCËS

Ekipi u certifikuar për ndihmë të parë dhe për fikje të zjarrit.

INCIDENTET, AKSIDENTET

0

Nuk kas pasur LTI (lëndime me kohë të humbur në punë) në vitin 2019

KPI-të (Treguesit Kryesorë të Performancës) në vitin 2019

0

Shkalla me Kohë të Humbur në Punë nga Lëndimi (LTI FR) për punonjësit e drejtpërdrejt

0

Shkalla me Kohë të Humbur në Punë nga Serioziteti i Lëndimit (LTI SR) për punonjësit e drejtpërdrejt

0

Shkalla me Kohë të Humbur në Punë nga Lëndimi (LTI FR) për personelin kontraktues

IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE

100%

Numri i rreziqeve të raportuara (19) nga (19)

VËZHGIMI PËR VLERËSIMIN E SIGURISË NË PUNË

95%

Numri i vëzhgimeve (20) nga (21)

93%

Numri i kontrolleve (14) nga (15)

116%

Inspektimi i objekteve dhe inspektimi i aktivitetit (331) nga (285)

GJETJET SIPAS VEPRIMEVE PROAKTIVE

89%

Gjetjet nga vëzhgimet, kontrollet dhe inspektimet, kushtet e pasigurta kanë qenë (446), është vepruar në (395)

PROMOVIMI I KOMUNIKIMIT TË HAPUR

Numri i shmangieve të afërta të raportuara

13

50

Numri i veprimeve të pasigurta të raportuara

318

Numri i kushteve të pasigurta të raportuara

100%

të shmangieve të afërta të raportuara për të cilat një përgjigje me shkrim i është dhënë personave që i kanë raportuar ato

TRAJNIMET PËR PUNONJËSIT TANË

Numri total i punonjësve

255

4,943

Numri i orëve të planifikuara për trajnime për punonjës

5,340

Numri i orëve të trajnimeve të mbajtura për punonjës

20.94

Numri mesatar i orëve të mbajtura në trajnime lidhur me Shëndetin dhe Sigurinë për një punonjës

TRAJNIMET PËR KONTRAKTORËT TANË

159

Numri total i kontraktorëve (i shprehur në orar të plotë)

1,234

Numri i orëve të trajnimeve të mbajtura për kontraktorët

PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE PËR SIGURINË

Në vitin 2019, është kryer një trajnim dhe simulim kundër zjarri në bashkëpunim me autoritetet përkatëse lokale të komunës. Ngritja e vetëdijesimit për shëndetin dhe sigurinë është shumë e rëndësishme për Sharrcemin, në mënyrë që të performojmë edhe më mirë në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë për të gjithë punonjësit tanë të drejtpërdrejt dhe për kontraktorët.

TRAJNIMI DHE SIMULIMI KUNDËR ZJARRIT

Ne vazhduam me angazhimin tonë për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe kemi kryer aktivitete të ndryshme gjatë gjithë vitit për këtë qëllim. Trajnimet dhe simulimet kundër zjarrit u mbajtën brenda ambienteve tona, në bashkëpunim me palët përkatëse të interesit. Ne konsiderojmë se çdo lloj trajnimi për sigurinë është i dobishëm dhe i rëndësishëm për të gjitha palët e përfshira. Trajnimet kundër zjarrit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procedurave tona të sigurisë ndaj zjarri për shumë arsye. Jo vetëm që duam të sigurojmë që të gjithë punonjësit tanë, klientët dhe vizitorët në ambientet tona të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë në rast të ndonjë zjarri, por gjithashtu duam që të gjithë të shohin se sa efektiv është plani ynë i evakuimit nga zjarri dhe të përmirësojmë aspekte të caktuara të parandalimit të zjarrit. Një trajnim i tillë është një provë për të verifikuar që alarmet tona të zjarrit po

funksionojnë dhe gjithashtu na ndihmon të kontrollojmë pajisjet tona. Programet e tilla të edukimit / trajnimit kanë dëshmuar të jenë efektive në uljen e jo-efikasitetit dhe në adresimin e faktorëve të rëndësishëm.

TRAJNIMI ME PËRFAQËSUESIT KOMUNAL, AUTORITETET POLICORE DHE BRIGADËN E ZJARRFIKËSVE

Sharrcemi vazhdimisht përpiqet të promovojë sjellje të sigurt dhe të duhur në të gjithë organizatën gjatë aktiviteteve tona të përditshme dhe të krijojë një mjedis në të cilin të gjithë ne jemi përgjegjës për sigurinë tonë dhe të kolegëve tanë. Përveç sigurimit të identifikimit të të gjitha detyrimeve ligjore në lidhje me shëndetin dhe sigurinë dhe adresimin e tyre në një mënyrë të kënaqshme, përcaktimin e të gjitha funksioneve të nevojshme të shëndetit dhe sigurisë në punë të kërkuara nga legjislacioni kombëtar dhe lokal, angazhimet tona për shëndetin dhe sigurinë vazhdojnë të përfaqësojnë një prioritet kryesorë për Sharrcemin. Ne gjithashtu duam të ndajmë njohuritë tona dhe angazhimin tonë për Shëndetin dhe Sigurinë me palët tona të interesit. Në vitin 2019, u organizua një trajnim për përfaqësuesit e institucioneve publike, me temën “Mbrotja nga zjarri”. Trajnimi u zhvillua në ambientet e Komunës së Hanit të Elezit nga Menaxheri ynë për Shëndet dhe Siguri.



SHPËRBLIMI PËR ANGAZHIMIN TONË PËR SHËNDET DHE SIGURI

Në javën Evropiane për shëndetin dhe sigurinë në punë, përkatësisht nga data 21 deri më 25 tetor 2019, si pjesë e projektit “Mbështetje për Inspektoratin e Punës në Luftimin e Punës së Padeklaruar”, OJQ-ja KOSHA organizoi një fushatë për vende të shëndetshme të punës, përkatësisht se si kompanitë mund të përmirësojnë kushtet e tyre të punës duke menaxhuar substanca të rrezikshme brenda mjediseve të tyre. Sharrcem mori pjesë në këtë fushatë me

dy praktika më të mira dhe kompania jonë ishte fituese e çmimit të praktikës së mirë për ruajtjen dhe asgjësimin e kimikateve në laboratorin e Sharrcemit. Kjo iniciativë kishte të bënte me angazhimin tonë për të ulur rrezikun, për të respektuar kërkesat ligjore, si dhe për të marrë masa të avancuara për shëndetin dhe kulturën e sigurisë dhe për të promovuar vlerat tona korporative. Ngjarja në fjalë u mbështet nga institucione shumë të rëndësishme dhe u mbajt në tetor në Prishtinë, me pjesëmarrës të shumtë nga sektori publik dhe privat.



TRAJNIMI/LIGJËRATA MBI KONSUMIMIN E USHQIMIT TË SHËNDETSHËM

Një nga objektivat e Sharrcemit është të organizojë trajnime dhe aktivitete të tjera për të ngritur zërin për shqetësimet me të cilat përballet shoqëria kosovare, si dhe për të ndikuar që të veprojnë palët kryesore të interesit. Gjatë vitit raportues, Sharrcemi mbajti një trajnim dy-ditor me theks në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme të shkaktuara si rezultat i mos konsumimit të ushqimit të shëndetshëm.

Ky aktivitet trajnues nxjerr në pah rëndësinë e konsumimit të ushqimit të shëndetshëm dhe investimit në arsim dhe kërkim për të adresuar këtë problem në mesin e punonjësve. Prandaj, në këtë drejtim, ne ftuam një specialist / nutricionist për të ofruar këtë trajnim / ligjëratë për të gjithë punonjësit tanë. Trajnimi dhe diskutimet kanë qenë të planifikuara për të gjithë punonjësit, duke i edukuar ata mbi domosdoshmërinë dhe rëndësinë e konsumimit të ushqimit të shëndetshëm.

NJERËZIT TANË: PROGRAMET E ZHVILLIMIT DHE ANGAZHIMIT



Faktori më i rëndësishëm për suksesin dhe performancën e kompanisë në arritjen e qëllimeve dhe synimeve të saj është fuqia e saj punëtore. Kështu që, Sharrcemi rregullisht e çmon kapacitetin dhe angazhimin e punonjësve të saj.

Prandaj, kompania jonë vazhdon të mbetet e përkushtuar në ofrimin e kushteve më të mira të mundshme për punë, rritjen e sigurisë në ambientin e tyre të punës dhe ofrimin e mundësive të zhvillimit të karrierës. Ne respektojmë të drejtat e punonjësve dhe sigurojmë paga që plotësojnë praktikën e mira të biznesit. Fuqia jonë punëtore përbëhet nga 244 punonjës të drejtpërdrejtë.

Meqenëse njerëzit tanë janë elementi kryesor i suksesit tonë, ne u ofrojmë atyre jo vetëm një ambient të sigurt pune por gjithashtu u sigurojmë atyre mundësi ku ata mund të mësojnë gjëra të reja çdo ditë dhe t'i fuqizojnë ata që të përballojnë sfidat.

Zhvillimi i tyre është gjithashtu pjesë e rritjes së qëndrueshme të kompanisë. Prandaj, në vitin 2019 punonjësit tanë ndoqën një larmi trajnimesh që i shërbejnë zhvillimit të tyre teknik dhe profesional.

Më shumë detaje janë paraqitur në pjesën e KPI-ve për Indeksin e Performancës Sociale me të dhënave të konsoliduara për tri vitet e fundit (2017- 2019).

NUMRI I PUNONJËSVE NË VITIN 2019

244

Numri total i
punonjësve

0

Numri i punonjësve të
përkohshëm

244

Numri i punonjësve
me orar të plotë

PUNONJËSIT SIPAS GJINISË

5%



11

Femra


233

Meshkuj



95%

ANËTARËT E BORDIT TË ZGJERUAR MENAXHUES



ANËTARËT E SINDIKATËS

45

Jo

199

Po

PUNËSIME TË REJA

0



0

PUNONJËSIT QË JANË PENSIONUAR

4



34

Numri i paraqitur i punonjësve që largohen nga kompania jonë është rezultat i zbatimit të Planeve Vullnetare të Pensionit të Hershëm (VELP), që synojnë përtëritjen e strukturës sonë të punësimit. Qarkullimi i punonjësve femra ishte pak më i ulët se qarkullimi i punonjësve meshkuj. Më shumë detaje rreth programit në fjalë janë paraqitur në Raportin e vitit 2014, i cili është në dispozicion në uebfaqen tonë.



TË DREJTAT E NJERIUT, ÇËSHTJET E PUNËS DHE MUNDËSITË E BARABARTA

Mbrojtja e të drejtave të njeriut mbetet një temë shumë e rëndësishme në Sharrcem. Kompania jonë gjithashtu zbaton standardin ndërkombëtar SA 8000 në të gjitha aspektet e të drejtave dhe marrëdhënieve me punonjësit tanë.

- Draft vlerësimi i punës i përfunduar për të gjithë punonjësit.
- Hendeku i pagave sipas gjinisë dhe nivelit të punës (është përfunduar).

PLATFORMA E TITANIT PËR ETIKË DHE LIDERSHIP

Kjo platformë paraqet një sërë sjelljesh që mbështesin indin lidhës të etikës dhe aftësisë së punonjësve tanë që bëjnë pjesë në sukseset e kompanisë sonë dhe platforma ju prezantua punonjësve tanë që mbajnë pozita kyçe në fabrikë.

PËRFSHIRJA E PUNONJËSVE DHE PROCESI I ZHVILLIMIT TË NJERËZVE

Përmes performancës dhe procesit tonë të zhvillimit, si dhe përmes vlerësimit të performancës, ne kemi krijuar një kanal të hapur komunikimi dhe të transparencës në Sharrcem.

STANDARDI I LLOGARIDHËNIES SHOQËRORE (SA 8000)

Sharrcemi është ri-certifikuar në vitin 2019 me standardin ndërkombëtar (SA 8000), dhe është kompania e parë dhe e vetme në vend që ka marrë një certifikim të tillë. Ky standard mbështet përgjegjësinë dhe llogaridhënien shoqërore duke siguruar zbatimin e sistemeve të besueshme të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit dhe komunitetin. Ne e konsiderojmë këtë standard si një

hap të mëtejshëm në angazhimin tonë të vazhdueshëm për të menaxhuar përmes sistemeve të certifikuara, në mënyrë që të ruajmë qeverisjen dhe transparencën e mirë.

SISTEMI I GRUPIT PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE (GHRMS)

- Sistem qendror për punonjësit.
- Performanca dhe objektivat.
- Planifikim për zhvillim të karrierës.
- Sistem i menaxhimit të aftësisë.

TRAJNIME ONLINE PËRMES LINKEDIN

Marrë parasysh që qëllimi i GHRMS është të përmirësojë përvojën e punonjësve dhe thjeshtëzimin e punës në menaxhimin e njerëzve, për të promovuar shkëmbimin e informacionit dhe rrjetëzimin global midis punonjësve, për të siguruar burime mësimore që përshpejtojnë përparimin, për të rritur zhvillimin e punonjësve dhe për të siguruar një orientim organizativ që kontribuon në zhvillimin e grupit, nën ombrellën e kësaj platforme, Sharrcemi lansoi platformën LinkedIn në internet ku të gjithë punonjësit e Grupit mund të qasen në mijëra trajnime në internet.

“unTe PEOPLE”

Kjo platformë është në funksion dhe ofron procese të ndryshme të BNj-së (Burimeve Njerëzore), kështu që punonjësit do të përfitojnë nga kjo platformë e re. Moduli për rekrutim është krijuar në vitin 2019.

EDUKIM I VAZHDUESHËM

- 5 punonjësve u janë dhënë bursa në vitin 2019 (gjithsej 23 në vitet e kaluara).
- 25 praktikantë në periudhën janar-dhjetor 2019.

ORËT ME TRAJNIME

PUNONJËSIT E TRAJNUAR SIPAS TEMËS	MESHKUJ	ORË	FEMRA	ORË	TOTALI	ORË
CSR (Përgjegjësi Shoqërore Korporative)	0	24	0	1	0	25
Pajtueshmëri/Përputhshmëri	1	258	0	6	1	264
Digjitale	10	427	2	11	12	438
Mjedis	1	89	9	0	1	89
Gjuhë të huaja	0	104	0	0	0	104
Kompetenca funksionale	1	18	0	0	1	18
Kompetenca të përgjithshme	8	896	0	80	8	976
Shëndet dhe Siguri	215	5,166	11	174	226	5,340
Aftësi menaxheriale	2	304	1	48	3	353
Të tjera	5	114	0	30	5	144
Njohuri teknike	0	134	0	36	0	170

*** Llogaritja e numrit të përgjithshëm të punonjësve të trajnuar nuk merr parasysh pjesëmarrjen e shumëfishtë të një personi (të dhënat përsëriten kur punonjësit e njëjtë marrin pjesë në më shumë se një program). Në këtë rast, llogariten vetëm orët e trajnimit.

SINDIKATA

Sharrceci ka një marrëveshje kolektive e cila përfshinë të gjithë punonjësit. Procesi i pensionimit është trajtuar në mënyrë ligjore, por Sharrceci ka treguar gatishmëri për të mbështetur punonjësit të cilët dëshirojnë t'i bashkohen programit për t'u larguar

më heret - VELP, në pajtim me rregullat e Grupit. Në vitin 2019, Sharrceci gjithashtu organizoi një iftar për të gjithë punonjësit, e cila është një ngjarje që përdoret për të përgëzuar punonjësit për punën që e kanë bërë gjatë viteve në Sharrcem dhe të cilët ishin pranë largimit nga puna përmes programit VELP.



NGJARJE DHE TAKIME

- Takime të rregullta të bordit të zgjeruar menaxhues.
- Takime / komisione të ndryshme.
- Takime individuale / Politikë për komunikim të drejtpërdrejt me Burimet Njerëzore.
- Përzgjedhja e stafit më të mirë për Shëndet dhe Siguri, dhe e punonjësit më të mirë për Shëndet dhe Siguri.

AKTIVITETE VULLNETARE

- Dhurimi i gjakut.
- Let's Do it Kosovo.
- Vetëdijesim përmes trajnimeve.

ANGAZHIMI ME PUNONJËSIT TANË: ANKETA PËR PUNONJËSIT NË VITIN 2019

Anketa për punonjësit e Grupit në vitin 2019 është përmbyllur. Anketa u administrua me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit në këtë anketë të shprehin mendimin e tyre. Informatat kthyes (feedback) të pjesëmarrësve ishin shumë të rëndësishme për ta bërë organizatën një vend më të mirë për të punuar. Rezultatet ju komunikuan Menaxhmentit dhe do t'ju komunikohen të gjithë punonjësve në fillim të vitit të ardhshëm. Grupi do të vazhdojë të përdorë njohuritë nga anketa për të identifikuar prioritetet dhe për të kryer veprime përkatëse.

MEKANIZMI PËR ANKESA (PROCEDURA)

Në kompaninë tonë është duke u zbatuar sistemi i integruar i parimeve, procedurave dhe programeve për menaxhimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me punonjësit tanë. Garancia e jashtme e standardit SA 8000 garanton se të gjitha proceset dhe procedurat ekzistuese janë adekuate dhe në përputhje me politikën për CSR, kodin e mirësjelljes dhe kornizën e Grupit TITAN për menaxhimin e njerëzve. Një mekanizëm i ri për ankesa është përfunduar dhe u është komunikuar të gjithë punonjësve. Ky mekanizëm për ankesa është i rëndësishëm për punonjësit tanë pasi ofron udhëzime dhe siguri në punë, dhe si rezultat, rrit efikasitetin e organizatës sonë.

DOBITË TJERA

- Pagesa shitesë për të gjithë punonjësit për festa fetare.
- Mbulimi i 50% të shpenzimeve lidhur me shpenzimet e pushimeve verore të punonjësve të Sharrcemit, përmes Sindikatës.

KOMUNIKIMI

- Stenda (Billborde)
- Kutitë për sugjerime, etj.

SHËNDETI DHE MIRËQENIA

- Plan vullnetar shëndetësor për të gjithë punonjësit.
- Kontrolle shëndetësore sistematike.
- Mjeku i përgjithshëm në vendin e punës.
- Dhënia e barnave të gjithë punonjësve për terapi të rregullta (sëmundje kronike) dhe OTC.
- Trajtime lidhur me stresin nga nxehtësia.
- Vetëdijësimi përmes trajnimeve.

Përveç sigurimit mjekësor që kemi, në vitin 2019, Sharrcemi ka iniciuar / planifikuar edhe sigurimin e jetës për të gjithë punonjësit e tij.

TASK FORCA

Sharrcemi vazhdon ta konsiderojë të gjithë personelin e tij si një pasuri të madhe që kontribuon në aktivitetet e Sharrcemit për CSR dhe kështu siguron kushte të përshtatshme për të gjithë për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Sharrcem mban Taskforcën e themeluar për CSR për të përfaqësuar kompaninë në Rrjetin CSR dhe për të zbatuar strategjinë e kompanisë në aspektin e CSR-it. Në mënyrë që ekipi të mbajë komunikimin dhe marrëdhëniet me palët tjera të interesit për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, ata gjithashtu morën pjesë në ngjarje të ndryshme për të ndarë njohuritë dhe përvojave të tyre dhe, nga ana tjetër, për të marrë informacione të dobishme.

SHPËRBLIMI PËR PUNONJËSIT MË TË MIRË

Një ngjarje u organizua për të shpërblyer punonjësit që respektojnë më së miri rregullat e sigurisë në punë. Në këtë ngjarje morën pjesë palë të ndryshme të interesit dhe u diskutua gjatë për praktikën më të mira për shëndetin dhe sigurinë, rregullat dhe rregulloret, dhe Sharrcemi u vlerësua se ishte angazhuar dhe përkushtuar për

shëndetin dhe sigurinë. Në të njëjtën ditë u përzgjedhën dhe u shpërblyen punonjësi, menaxheri dhe ekipi i Sharrcemit që ju përmbajtën më së miri rregullave të sigurisë në punë. Me organizimin e iniciativave të tilla, Sharrcemi synon të zhvillojë dhe përmirësojë vazhdimisht marrëdhëniet e mira me të gjitha palët e brendshme dhe të jashtme të interesit për respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë.



PROGRAMI SHITESË PËR ZHVILLIM

Sharrcemi ka iniciuar një program tjetër të brendshëm për zhvillimin e punonjësve të tij. Ky program ka treguar rezultate në përgatitjen e punonjësve për detyrat e tyre aktuale dhe të ardhshme, dhe rezultoi në rritjen e besnikërisë dhe përkushtimit ndaj kompanisë, dhe ka ndihmuar individët në rritjen e karrierës së tyre. Ka pasur interesim të madh nga punonjësit në vitin 2019 për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme për të fituar aftësi dhe njohuri të reja.

Prandaj, duke marrë parasysh interesimin dhe gatishmërinë e tyre, kompania ka organizuar disa lloje trajnimesh bazuar në nevojat e punonjësve për zhvillimin e tyre. Si rezultat, ne kemi nënshkruar një marrëveshje me Institutin Austriak të Ekselencës (AIEEx) për të siguruar trajnime dhe për të pasur trajnerë të specializuar. Trajnimet e ofruara nga AIEEx ishin shumë të mirëseardhura, praktike dhe të dobishme për punonjësit që morën pjesë në ato trajnime.

KONFERENCË PËR PARIMET UDHËZUESE PËR BIZNESIN DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Nën ombrellën e projektit “Nxitja e Parimeve për Biznes dhe të Drejta të Njeriut”, financuar nga Bashkimi Evropian në Maqedoninë e Veriut, u organizua një konferencë një-ditore për “Parimet Udhëzuese për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut”. Qëllimi ishte mbledhja e të gjitha palëve relevante të interesit dhe dhënia e mundësisë për të shprehur përkushtimin e tyre ndaj Parimeve Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe për të rritur vetëdijesimin për rëndësinë e të drejtave të njeriut sipas perspektivës së biznesit.

Ngjarja u përdor si një diskutim i hapur për zbatimin e Parimeve Udhëzuese të OKB-së (UNGP) në politikat publike të shtetit dhe në politikat e brendshme të kompanive. Për më tepër, gjetjet nga studimi “Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Sektorin e Biznesit”, si dhe informacione mbi aktivitetet e projektit u ndanë me pjesëmarrësit në konferencë.

Të pranishëm në konferencë ishin pjesëmarrës të shumtë, përfshirë: kompanitë e angazhuara për përgjegjësi shoqërore, institucionet publike (ministri, agjenci, grupe të punës, përfaqësues nga organizata (sindikatat, odat, partnerët nga mediat)). Kompania jonë simotër, Usje - TITAN në Maqedoninë e Veriut luajti një rol shumë domethënës në këtë konferencë duke ndarë me pjesëmarrësit angazhimin dhe njohuritë e tyre mbi të drejtat e njeriut.

Drejtoresha e Grupit TITAN për CSR, Znj. Alexiou dha kontributin e saj në konferencë si folëse kryesore. Për shkak të rëndësisë së lartë të konferencës dhe mundësive të rrjetëzimit, palë të ndryshme të interesit, përfshirë ekipin e Sharrcemit morën pjesë në konferencë.

BASHKËPUNIMI ME EKIPIN E INXHINIERISË DHE TEKNOLOGJISË SË GRUPIT (GET), CSR DHE KOMUNIKIMET E BRENDSHME TË GRUPIT

Komunikimi i rregullt, bashkëpunimi dhe gatishmëria e tyre për të mbështetur të gjitha Njësitë e Biznesit (BU-të) konsiderohet si një mekanizëm shumë i rëndësishëm për të përmbushur me kohë dhe në mënyrë efektive planet dhe qëllimet për CSR. Takimet ballë për ballë, konferencat telefonike, udhëzimet e reja të përbashkëta, përvojat, praktikat më të mira, etj. na ndihmojnë t'i përgjigjeni më mirë, me kohë dhe në mënyrë profesionale palëve tona të interesit.

Platforma aktuale e brendshme e Grupit ka qenë gjithashtu shumë e dobishme për ne për zhvillimin e aktiviteteve të përditshme të biznesit. Kishte gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë me Grupin në lidhje me Intranetin e ri të Grupit që do të lansohet në vitin 2020, i cili do të na ndihmojë të jemi në kontakt dhe të mbajmë kontakte.

Ne presim që platforma e re të na sigurojë të gjitha lajmet për Grupin dhe Njësitë e Biznesit, të na frymëzojë me tregime interesante, të na japë qasje në informacione praktike dhe gjithashtu të na ndihmojë të njohemi më mirë!

connections
THE TITAN GROUP INTRANET

NDIHMJA E PARË

Gjatë vitit 2019, Sharrcemi bëri investime të ndryshme për mirëqenien e të gjithëve në fabrikë. Përveç kujdesit diagnostik, parandalues dhe rutinë të ofruar nga kompania për të identifikuar rreziqet e mundshme shëndetësore dhe për t'i adresuar ato në kohën e duhur, ne gjithashtu ofrojmë shërbime të ndihmës së shpejtë me orar të plotë, brenda ambienteve të kompanisë, si dhe sigurim shëndetësor për të gjithë punonjësit. Në fund të vitit 2018, kompania pajisi qendrën e ndihmës së shpejtë me një automjet të urgjencës, duke marrë parasysh që urgjencat mund t'i ndodhin çdokujt në çdo kohë dhe është shumë e rëndësishme që automjetet e urgjencës të arrijnë në vendin e ngjarjes sa më shpejt që të jetë e mundur. Mjeku dhe infermierja jonë morën pjesë në

trajnimin Mega-Code për temat: 1. Menaxhimi i traktit respirator; 2. CPR; 3. Farmakologjia në reanimacion – bazuar në sugjerimet e ERC-së (Këshilli Evropian i Riaftësimit) të vitit 2015 dhe të GRC-së (Këshilli Gjerman i Riaftësimit), dhe trajnimi u certifikua.

Ndërkohë, trajnime të tjera të rëndësishme u organizuan brenda kompanisë në lidhje me mirëqenien njerëzore, por përveç mjekut dhe infermieres, edhe 8 individë të tjerë të konsideruar si staf përgjegjës për automjetin e urgjencës kanë ndjekur gjatë vitit 2019 një trajnim profesional në Poliklinikën Rezonanca në Prishtinë dhe kanë marrë një certifikatë për temat e mëposhtme: Reanimacion; Defibrilim dhe Traumë. Sharrcemi do të vazhdojë të bëjë investime për këtë çështje shumë të rëndësishme.



ANGAZHIMI ME PALËT LOKALE TË INTERESIT

Shkalla e lartë e papunësisë, varfërisë dhe mungesa e mbështetjes së strukturuar për zhvillim mbeten çështje kritike për komunitetin tonë. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë vështirësitë dhe problemet aktuale me të cilat përballet shoqëria ku ne veprojmë. Në fillim të vitit 2010, Sharrcepi e analizoi me kujdes situatën në vend dhe në veçanti në Han të Elezit duke përdorur të gjitha burimet e informatave në dispozicion.

Që nga ajo kohë, kompania ka përgatitur plane strategjike për të adresuar problemet dhe çështjet e ndjeshme për komunitetin lokal. Ne bashkëpunojmë ngushtë me komunitetin tonë lokal drejt përmirësimit të jetës duke rritur mirëqenien e qytetarëve. Iniciativat tona të zbatuara dhe ato në zhvillim e sipër janë iniciuar me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës në zonën ku ne operojmë.

VEPRIMET NË VITIN 2019 JANË TË PARAQITURA NË VIJIM:

Kemi ofruar mundësi të shumta për punë praktike për brezat e rinj duke mbështetur veçanërisht grupet më të cënueshme që nuk kanë pasur mundësi të mëparshme për punësim ose mundësi për të ndjekur trajnime në vendin e punës.

Ne gjithashtu kemi qenë të angazhuar me të rinjtë për të rritur vetëdijesimin për çështje të ndryshme, të tilla si: promovimi i mbrojtjes së mjedisit, shëndetit dhe sigurisë dhe, përmes projektit LAB, kemi ndihmuar në krijimin e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme, me një fjalë – kemi ndihmuar në krijimin e vendeve të reja të punës, e cila ende vazhdon të jetë një nga çështjet më të ngutshme në ekonominë e komunitetit dhe të vendit.



KARAKTERISTIKAT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT



Lokacioni	Territori	Popullata	Punësimi	
			Të punësuar	Të papunë
Hani i Elezit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës dhe në afërsi të kufirit me Maqedoninë e Veriut.	Territori i Komunës së Hanit të Elezit përbëhet nga këto fshatra, vendbanime dhe lagje urbane: Hani i Elezit, Gorancë, Paldenicë, Krivenik, Seçishtë, Pustenik, Dimcë, Rezhancë, Neçavc, Vertomicë, Dromjak, Laç, Lagjia Uji i Thart, Lagjia e Re	Sipas të dhënave nga hulumtimet në terren, popullsia vlerësohet të jenë rreth 10,000 banorë, të cilët janë kryesisht shqiptarë etnikë	33%	67%



BASHKËPUNIMI RECIPROK, MONITORIMI DHE ANGAZHIMI ME KOMUNITETIN LOKAL PËRMES INICIATIVAVE / PROGRAMAVE QË JANË NË VAZHDIM E SIPËR

Duke ndjekur Politikën e Grupit TITAN për CSR, ne vazhdojmë të punojmë me zell për zbatimin e projekteve dhe proceseve të brendshme dhe të jashtme për të përmirësuar performancën tonë të përgjegjësisë korporative dhe të ndikimit në shoqëri. Prandaj, ne bëjmë shumë përpjekje për mbrojtjen e mjedisit, krijimin e një kulture të sigurisë dhe të një shoqërie më të shëndetshme si dhe krijimin e mundësive të punësimit. Palët e interesit janë një element kryesor për arritjen e planeve dhe qëllimeve tona, kështu që - ne vazhdojmë të ndërtojmë besimin me palët tona të interesit duke qenë të hapur dhe transparent në komunikimin tonë. Rëndësia e angazhimit me palët tona të interesit dëshmohej nga angazhimi ynë për të raportuar performancën tonë të qëndrueshmërisë me garancinë e jashtme të dhënë nga një palë e tretë dhe duke pasur dialog të vazhdueshëm me të gjitha palët kryesore të interesit për çështje materiale. Kompania jonë ka arritur të ndërtojë besim dhe bashkëpunim thelbësor me komunitetin dhe vazhdon të qëndrojë pranë tyre në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin e jetesës të tyre. Gjatë vitit 2019,

kompania jonë ishte pjesë e takimeve të ndryshme dhe e grupeve të biznesit për të siguruar ndarjen e njohurive, bashkëpunimin dhe ngritjen e vetëdijes publike në lidhje me çështjet dhe prioritetet lokale.

KONTRAKTORËT

Kontraktorët e Sharrcemit janë pjesë e rëndësishme dhe e drejtpërdrejtë e gjenerimit të aktivitetit të biznesit në çdo rajon dhe Sharrcemi ndjek një politikë standarde duke inkurajuar bashkëpunimin me furnizuesit dhe kontraktorët vendorë. Kjo është e rëndësishme për punët tona, por Kompania jonë gjithashtu kontribuon në rritjen ekonomike dhe në krijimin e vlerës në nivelin lokal. Ne e ndajmë njohurinë dhe ekspertizën me kontraktorët tanë duke ndërtuar marrëdhënie të besueshme dhe efektive. Përmirësimi i marrëdhënieve me kontraktorët tanë është sistemuar përmes Politikave të Brendshme, DoraObjektivat të Procedurave të Blerjes, ISO-së dhe Kodit të Mirësjelljes së Grupit për Prokurimin, të cilat gjithashtu rregullojnë çështjet e të Drejtave të Njeriut dhe korrupsionit. Gjithashtu japim kontribut të drejtpërdrejtë përmes Standardit SA 8000 për sa i përket qëndrueshmërisë dhe zhvillimit.

LABORATORI PËR AKTIVITETE TË BIZNESIT (LAB)

- Ka për qëllim të edukoj komunitetin lokal në fushën e ndermarrësisë.
- Krijon dhe zhvillon ndërmarrje të vogla dhe të mesme, në veçanti në sektorët e pylltarisë, bujqësisë dhe prodhimit të qumështit.
- Krijon bashkëpunim dhe angazhime afat-gjata me palët lokale të interesit.

BORDI KËSHILLUES LOKAL I PAVARUR (BOPAL)

- Zhvillon dhe Përmirëson Komunitetin Lokal
- Bordi Lokal Këshillues i Hanit të Elezit vendos për prioritetet.

BORDI PËR FËMIJË

- Ngritja e Vetëdijesimit
 1. Shëndeti dhe Siguria
 2. Mjedis



LABORATORI PËR AKTIVITETE TË BIZNESIT (LAB)



Ne veprojmë në Kosovë, afër kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe ftojmë të gjithë partnerët potencial të biznesit në nivelin lokal të respektojnë dhe të angazhohen sipas Standardeve të Titanit, siç përshkruhet në politikat përkatëse të Grupit dhe veçanërisht politikat për Shëndetin dhe Sigurinë, të Drejtat e Njeriut dhe Anti-Korrupsion. Shkalla e papunësisë dhe varfërisë ishte e madhe dhe mundësitë e punës ishin të pakta për popullsinë dhe ky problem vazhdon të jetë më i përhapur në Komunën e Hanit të Elezit, ku vepron kompania jonë. Në këtë aspekt, Sharrceci ka iniciuar këtë projekt në vitin 2014 për të krijuar ndërmarrje të reja të vogla dhe të mesme me qëllim për të ulur varfërinë dhe papunësinë. Edukimi i pjesëtarëve të komunitetit lokal në ndërmarrësi dhe menaxhim biznesi dhe bujqësi synoi t'i ndihmojë ata në krijimin e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme dhe në këtë mënyrë të krijojë mundësi punësimi. Sharrceci ka ndarë që nga fillimi një buxhet të konsiderueshëm për këtë projekt, përkatësisht për krijimin e projektit si dhe për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të projektit gjatë viteve. LAB konsiderohet si një nga arritjet e kompanisë sonë, pasi vazhdon me investime, dhe përfituesit e të cilave janë para së gjithash qytetarët dhe ka ndarë një

shumë të konsiderueshme parash për këtë projekt / iniciativë, duke mundësuar kështu krijimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në fushën e bujqësisë ku janë krijuar vende të punës. Projekti LAB po kontribuon në zhvillimin ekonomik të Komunës së Hanit të Elezit përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të bujqësisë dhe pemëtarisë të zonës në përputhje me strategjinë e Grupit TITAN për CSR. Rezultatet e LAB-it rregullisht u shpalosen palëve të interesit dhe ata gjithashtu kanë theksuar se rezultatet pozitive arrihen vetëm përmes komunikimit dhe bashkëpunimit.

Rezultatet e deritanishme, që nga viti 2014: 97 aktivitete bujqësore përfituan nga ky projekt. Viti 2019 u kategorizua gjithashtu një vit në të cilin përveç Sharrcemit, donatorë të tjerë gjithashtu kanë marrë pjesë në financimin e LAB-it, duke rritur kështu ndikimin në komunitet dhe duke ulur papunësinë përmes iniciativave të përbashkëta bashkëpunuese në sektorë të ndryshëm bujqësorë. LAB vepron me një grant që përbënë 90% të investimeve dhe me 10% tarifë të pjesëmarrjes që mbulohet nga përfituesit. Për më shumë detaje, ju lutemi vizitoni: www.lab-ks.org



HYSEN SHABANAJ

Kryeshef Ekzekutiv - LAB

Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj zhvillimet, si dhe arritjet e LAB-it që nga themelimi i tij. Së pari, do të doja të shfrytëzoja rastin si Kryeshef Ekzekutiv për të shprehur falënderimet dhe vlerësimet e mia për një marrëdhënie të shkëlqyeshme pune me menaxhmentin e Sharrcemit dhe Grupin TITAN në zbatimin e objektivave të projektit në komunën e Hanit të Elezit përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore bujqësisë dhe të pemëtarisë në zonë në përputhje me strategjinë e Grupit për CSR.

Ky projekt unik dhe afatgjatë i iniciuar nga menaxhmenti i Sharrcemit për krijimin e fondacionit (Marrëveshja për Donacion) e arritur më 6 shkurt 2014 që i është dhënë LAB-it, synon mbështetjen e fermerëve individualë që jetojnë në zonat rurale për të krijuar biznese të reja në sektorët e bujqësisë dhe pemëtarisë, sidomos nga investimet në blegtori, kultivimi i serrave, kultivimi i pemëve të vogla dhe të imëta,

Vlen të përmendet se në përgjithësi angazhimi i palëve të interesit, duke kontribuar në mënyra të ndryshme, ishte në një nivel shumë të lartë, veçanërisht ai i përfaqësuesve nga Komuna e Hanit të Elezit. Projekti krijoi 97 aktivitete të reja bujqësore, ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), dhe përfaqëson një kontribut të rëndësishëm duke ndihmuar fermerët për të krijuar vetë-punësim dhe siguri në të ardhura për familjet e tyre, si dhe në financimin e bizneseve të tyre të reja.

Gjatë vitit 2017, LAB ka siguruar dy grante: 1. Fuqizimi i Sektorit të Bujqësisë dhe Pemëtarisë në Han të Elezit - granti është siguruar nga (USAID) për Zhvillim Bujqësor dhe Mundësi Rurale (AGRO) – projekti do ta zgjeroj mbështetjen për 15 biznese të reja. 2. Diversifikimi i Fermës së Përpunimit të Qumështit – grant i siguruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) – një projekt që ka për qëllim përmirësimin e diversifikimit të fermës dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të këtyre bizneseve.

Në vitin 2019, kishte gjithashtu një iniciativë për të rinjtë: 1. Vlerësimi i tregut për mundësi të punësimit, nga Sharrcemi përmes LAB-it në bashkëpunim me Sektorin e Kontraktimit të Proceseve të Punës. Është shumë e rëndësishme të përmendet se donatorë të tjerë kanë marrë pjesë gjithashtu për të financuar LAB-in, duke rritur ndikimin në komunitet me uljen e papunësisë përmes iniciativave të përbashkëta bashkëpunuese në sektorë të ndryshëm të bujqësisë.

LAB-i u vlerësua gjithashtu si një praktikë e mirë gjatë seminarit ESEE në Institutin Agronomik Mesdhetar në Chania - Greqi në vitin 2017 si dhe gjatë Konferencës Ndërkombëtare për Ekonominë e Ballkanit dhe Vendeve të Evropës Lindore të mbajtur në Bukuresht në vitin 2019.

LAB-i gjithashtu ka siguruar përkushtimin e vazhdueshëm dhe të veçantë nga partnerët e tij përmes trajnimeve të përshtatura, takimeve dhe bashkëpunimit, në këtë rast të veçantë me IADK-në në Vushtrri dhe AFS-në në Selanik, me të cilat LAB kishte marrëveshje.

Bordi i LAB-it vazhdoi punën e tij sipas parimeve dhe mekanizmave të qeverisjes të vendosura nga Shërbimet Këshilluese të IFC-së. Ne gjithashtu kemi bashkëpunuar ngushtë që nga fillimi me Baker Tilly, të cilët kanë kontribuar në punën tonë me këshilla

financiare dhe shërbime të auditimit financiar.

Për më tepër, investimet kanë zgjuar interesim të fuqishëm në komunitet, gjë që rezultoi në rritjen e besimit në program. Është me rëndësi se procesi transparent dhe rigoroz i përzgjedhjes i përdorur në përzgjedhjen e fermerëve i ka çuar një porosi të fuqishme komunitetit duke konfirmuar programin si një iniciativë serioze dhe shembull i shkëlqyeshëm i një ndryshimi pozitiv.

PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE TRI- VJEÇARE NGA LAB-I (2014-2019)

- Totali i granteve të kontraktuara për bashkëfinancim të kostos së pranueshme të mallrave dhe inputeve të nevojshme për krijimin e 97 aktiviteteve të biznesit është: 580,970,38 €, dhe 262,602,23 € shtesë përbëjnë investime jo-financiare për mbulimin e shërbimeve të konsulencës, zyrën e administratës dhe ofrimin e trajnimeve falas dhe mbështetjes teknike për të gjithë përfituesit. Kjo u mundëson atyre qasje në trajnimin bazë dhe në njohuritë praktike për zbatimin e bujqësisë inovative dhe për të drejtuar me sukses biznesin e krijuar.
- Viti i gjashtë i investimeve përmbyllet me krijimin e 97 ndërmarrjeve të reja në 12 sektorë të ndryshëm të bujqësisë dhe pemëtarisë: serra, pemë të vogla (mjedra dhe dredhëza), kultivim të bletëve, kërpudha, serra për arra, bagëti (prodhimi dhe përpunimi i qumështit), vreshta, pylltari – shfrytëzimi i biomasës së drurit për prodhimin e energjisë, shpeztari – prodhimi i vezëve, barishte mjekësore dhe aromatike.

- Mbështetje teknike e ofruar për 785 përfitues të LAB-it dhe fermerë të tjerë individual të zonës.
- Deri më tani, 132 lloje të ndryshme të trajnimeve tematike profesionale dhe praktike në terren janë përgatitur për pronarët e tokave për t'i përmirësuar njohuritë për sa i përket teknologjisë së avancuar për bujqësi dhe blegtori intensive sipas standardeve.
- Të ardhurat totale neto të raportuara nga viti 2014 deri në vitin 2019 kanë arritur shumën prej 610,220.87 €, që është e barasvlershme me mbi 60% të objektivave të synuara të projektit LAB.
- Pjesëmarrja e grave si përfituese të mbështetjes nga LAB është premtuese. Deri më tani, nga 97 përfitues 15% e këtyre përfituesve nga LAB janë gra.

Unë konsideroj se ka ende gjëra për të bërë në mënyrë që të zgjerohen investimet dhe të vazhdojmë të praktikojnë parimet e suksesit që i kemi arritur gjatë këtyre viteve.

RRITJA EKONOMIKE NË KOMUNITET

- Janë krijuar 97 ndërmarrje të reja.
- Janë siguruar grante.
- Janë mbajtur trajnime.
- Është bërë fuqizimi i gruas.



97, përfshirë 15 të themeluara nga USAID



NUMRI TRAJNIMEVE TË ORGANIZUARA DHE I PERSONAVE TË TRAJNUAR



MONITORIMI

Për të gjurmuar dhe kuptuar ndikimin e plotë të këtyre intervenimeve, ekipi i LAB-it krijon forma të brendshme për të marrë në mënyrë sistematike të dhëna nga përfituesit në lidhje me performancën e tyre vjetore.

Rëndësia e analizës së këtyre të dhënave ndihmon në identifikimin e dobësive dhe përparësive të kësaj mbështetjeje, si dhe mundësinë për të intervenuar kur është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri të aktiviteteve të biznesit dhe për të përmbushur kushtet e marrëveshjes.

PROCESET

Procesi i mbështetjes dhe përdorimit të granteve zhvillohet në përputhje me strategjinë e Grupit TITAN për CSR dhe me politikat e zbatueshme, si dhe me udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës për OJQ-të. Procesi i krijuar nga LAB, përbën një punë bashkëpunimi duke përfshirë palët kryesore të interesit në gjashtë vitet e fundit në marrjen e vendimeve për ofrimin e mundësive të financimit si një metodë e përshtatshme për të përshpejtuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe pemëtarisë i cili është ende i pazhvilluar dhe për të zbatuar objektivat e programit.

PAJTUESHMËRIA

Që nga themelimi i tij, projekti ka bashkëpunuar me të gjitha palët kryesore të interesit dhe ka ofruar një mjedis mbështetës për zbatimin e objektivave të planifikuara në një mënyrë plotësisht transparente dhe në përputhshmëri për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre të reja.


TRANSPARENCA NË LAB

LAB është ndërtuar mbi kornizën e partneritetit midis sektorit privat dhe atij publik. Është një shembull unik i angazhimit dhe bashkëpunimit të palëve të interesit me rezultate të prekshme pozitive 6 vjet pas themelimit të tij. LAB vazhdon kryerjen e detyrave të tij duke zbatuar procedura standarde të përcaktuara dhe duke përfshirë të gjithë palët e interesit / grupet e interesit (institucionet komunale dhe partnerët e komunitetit lokal), në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë transparente dhe të pranueshme nga të gjitha grupet dhe palët e interesit, veçanërisht për ata që jetojnë në zonat rurale. Nga kjo punë bashkëpunuese, LAB-i ka fituar pranimin dhe besimin nga të gjitha grupet përkatëse, gjë që tregon se projekti ka krijuar një marrëdhënie të fortë me komunitetin lokal dhe ka vendosur themelet për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e sektorit të bujqësisë dhe pemëtarisë. Gjatë kësaj periudhe nuk është regjistruar asnjë ankesë ose kundërshtim.

SASIA E PRODHUAR DHE VLERA NGA SHITJET

397,048

2019



1,241,392

nga viti 2014 deri
më 2019SASIA E PRODHUAR NË kg./lit./pcs. DHE m³

203,852

2019



610,220.87

nga viti 2014 deri
më 2019

VLERA TOTALE NGA SHITJET NË EURO



PARTNERËT DHE MIQTË E LAB-it

Gjatë vitit 2019, LAB-i gjithashtu ka siguruar përkushtimin e vazhdueshëm dhe të veçantë nga partnerët e tij përmes trajnimeve të përshtatura, takimeve dhe bashkëpunimit. Bordi i LAB-it vazhdoi punën e tij sipas parimeve dhe mekanizmave në fuqi për qeverisje dhe ka treguar gatishmërinë dhe përkushtimin e tij për projektin. Burimet e Sharrcemit ishin gjithashtu në dispozicion në çdo kohë për të kontribuar dhe mbështetur, përkatësisht duke ofruar mbështetje administrative dhe logjistike për LAB-in, ndërsa Komuna e Hanit të Elezit gjithashtu ka qenë tërësisht e gatshme për ta ndihmuar projektin. Është e rëndësishme të theksohet se për të gjashtin vit radhazi, LAB-i bashkëpunoi ngushtë me Baker Tilly në lidhje me këshillat financiare, dhe ata i kanë ofruar LAB-it shërbime falas të auditimit financiar.

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM / LAB

LAB, në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit dhe kompaninë DST nga Ferizaj, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi në vitin 2019 për bashkëfinancimin e një projekti për kultivimin e dredhëzave. LAB ishte përgjegjës për të financuar gardhin e zonës duke përfshirë shtyllat, ndërsa Komuna mori përgjegjësinë për të financuar sistemin e ujitjes dhe kompania DST siguroi bimët e dredhëzave, si dhe shtresën e najlonit. Vlen të përmendet se gjatë vitit edhe donatorë të tjerë morën pjesë në financimin e projektit LAB.

VLERËSIMET PËR LAB-in

Gjatë vitit 2019, LAB u vlerësua gjithashtu si praktika më e mirë nga International Journal of World Economics. Ekonomia e Ballkanit dhe të Vendeve të Evropës Lindore në Botën në Ndryshim organizuan Konferencën e 11-të Ndërkombëtare që u mbajt në maj 2019, në Bukuresht dhe LAB së bashku me Shkollën Amerikane të Fermave - Kolegji Perrotis në Selanik morën pjesë në ngjarje. LAB u vlerësua si praktika më e mirë, përkatësisht ndikimi i iniciativave CSR të Sharrcemit në zhvillimin e komunitetit rural.



NUMRI I KRIJUAR I DITËVE TË PUNËS (MESHKUJ/FEMRA)

4,126

2019



12,489

nga viti 2014 deri
më 2019

DITËT E PUNËS TË KRIJUARA - (MESHKUJ)

2,353

2019



5,949

nga viti 2014 deri
më 2019

DITËT E PUNËS TË KRIJUARA (FEMRA)

6,479

2019



18,438

nga viti 2014 deri më 2019

NUMRI TOTAL I DITËVE TË PUNËS



BORDI I PAVARUR LOKAL (BOPAL)

Në vitin 2011, Sharrcemi ka krijuar iniciativën e “Bordi i Pavarur Lokal” (në tekstin mëtejshëm: “BOPAL”), icili u riemërua pas vitit 2016 dhe përdor akronimin e përkthimit në shqip “BOPAL”. Qëllimi i kësaj iniciative për CSR dhe programi i veprimeve ishte të përcaktojë prioritetet e nevojave të komunitetit lokal, fokusi absolut të jetë në Komunën e Hanit të Elezit, dhe të ndajë fonde për mbështetjen e zhvillimit të komunitetit dhe përmirësimin e standardeve të jetesës së komunitetit. Që nga fillimi i hershëm i funksionimit të BOPAL-it, Menaxhmenti i Sharrcemit ka luajtur rolin e ‘mundësuesit’, para së gjithash duke zhvilluar qeverisjen dhe procedurat për të vendosur në Bord me unanimitet, dhe më tej duke siguruar një shkallë të lartë të përfshirjes dhe bashkëpunimit. Bordi i BOPAL-it takohet rregullisht në ambientet e komunës dhe gëzon një reputacion të shkëlqyeshëm dhe mbështetje nga palët e tij të interesit. Sharrcemi u nderua që mori Çmimin Evropian për CSR në vitin 2013 për iniciativën e tij të CSR për Bordin BOPAL (që kishte emrin ILAB në atë kohë) dhe nuk i zvogëloj aspak përpjekjet e tij të përgjegjësisë shoqërore që nga ajo kohë. Përkundrazi, Sharrcemi mbeti i angazhuar edhe përmes iniciativave të tjera, veçanërisht përmes iniciativës për CSR me projektin (LAB).

Në vitin 2019, Sharrcemi përmes BOPAL-it, mbështeti komunitetin lokal me një larmi iniciativash / aktivitësh, të tilla si: kulturore, sportive dhe ndihma individuale të solidaritetit. Financimi për komunitetin lokal përmes BOPAL në vitin 2019 ishte 15.000 Euro nga gjithsej 176.071 Euro të Investuara në Shoqëri, të cilat përgjithësisht janë regjistruar si ‘Donacione’. Financimi i përgjithshëm i BOPAL-it që nga fillimi i iniciativës në vitin 2011 ishte 172,927 Euro (shuma kumulative mes viteve 2011-2019).

Përmes vazhdimit të kësaj iniciative, Sharrcemi synon të thellojë bashkëpunimin dhe komunikimin me komunitetin në të cilin vepron, me qëllim të forcimit të transparencës dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të palëve kryesore të interesit. Sharrcemi e konsideron ftesën që i bëhet komunitetit lokal dhe palëve të interesit për të marrë pjesë në bordin e krijuar, si një hap i mëtejshëm në këtë angazhim. Kjo është një qasje inovative drejt përmbushjes më efikase të nevojave të komunitetit tonë me burimet që ne i vendosim në dispozicion për përmirësimin e mirëqenies së tij. Ne jemi të bindur se kjo iniciativë adreson më së miri sfidat lokale përmes konsensusit në shkallë të gjerë dhe vendosjes së prioritetëve të drejta dhe, për këtë arsye, kjo iniciativë e rrit faktorin e qëndrueshmërisë afatgjate në zhvillimin e komunitetit tonë.

15,000

EUR

Financimi i BOPAL-it
në vitin 2019

172,927

EUR

Shuma totale e financimit të
BOPAL-it (shuma kumulative
mes vitit 2011-2019)

AKTIVITETE DHE ANGAZHIME TJERA

UJI I PIJSHËM

Kemi vazhduar zbatimin e këtij projekti edhe në vitin 2019 duke siguruar ujë të pijshëm për shkollën fillore, shkollën e mesme, qendrën e mjekësisë familjare në Han të Elezit si dhe për komunën. Përmes këtij aktiviteti / projekti, Sharrcepi po përmirëson kushtet e jetesës së nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi, duke siguruar ujë të sigurt për pije. Kjo iniciativë gjithashtu rrit vetëdijesimin për të kuptuar rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të tilla dhe ngritjen e zërit kur mungojnë shërbimet e duhura.

SHKATHTËSITË PËR TË RINJTË / TË RINJTË KANË RËNDËSI

Ne u bashkuam në iniciativën e Pakti për Rini dhe krijuam një angazhim afatgjatë për të adresuar çështjet e të rinjve dhe për të ofruar mundësi për të ndërtuar aftësi në të ardhmen. Pakti për Rini vazhdon të renditet në krye të agjendës sonë dhe është një temë shumë e rëndësishme për planet dhe veprimet tona. Gjatë vitit 2019, 25 të rinj u inkuadruan në punë praktike dhe trajnime në kompaninë tonë. Ata fillimisht kanë mbajtur trajnim për Shëndetin dhe Sigurinë dhe më pas u caktuan në fushat e tyre të interesit.



LET'S DO IT KOSOVA

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se kjo iniciativë mbarë botërore ka një qëllim të rëndësishëm për të rritur vetëdijesimin e nxënësve për ruajtjen e një mjedisi të pastër. Në shenjë të vullnetit tonë të mirë, ne gjithashtu u bashkuam në këtë fushatë në vitin 2019 dhe inkurajuar komunitetin të japin mbështetjen e tyre dhe të bashkojmë forcat, në krijimin e një mjedisi më të pastër për të gjithë. Përmes kësaj iniciative dhe bashkëpunimit me palët përkatëse të interesit, ne kontribuojmë pozitivisht në mjedis.

VIZITA E NXËNËSVE NGA SHKOLLA E MESME

Me qëllim të informimit dhe edukimit të brezit të ri, përkatësisht nxënësit në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe me qëllim të ofrimit të njohurive për teknologjinë e prodhimit të çimentos, në bashkëpunim me shkollat në Han të Elezit, ne akomoduar nxënësit dhe organizuam një ligjëratë duke u ofruar atyre njohuri të përgjithshme mbi procesin e prodhimit të çimentos përmes një prezantimi të përgatitur nga menaxheri ynë për mjedisin. Projektet e përgjithshme mjedisore dhe angazhimi ynë për mbrojtjen e mjedisit ju prezantuan atyre në mënyrë që të rritet vetëdijesimi, veçanërisht tek nxënësit për sa i përket çështjeve të mjedisit.

VIZITA E STUDENTËVE NGA UNIVERSITETI

Ne jemi të hapur për të mirëpritur palët e interesit në ambientet tona në çdo kohë, veçanërisht studentët. Një vizitë studimore u organizua nga studentët e Fakultetit të Kimisë nga Universiteti Publik i Prishtinës. Ata kanë parë nga afër teknologjinë e prodhimit të çimentos, aktivitetet dhe angazhimet mjedisore, kontrollin e

cilësisë dhe pajisjet laboratorike. Gjatë kësaj vizite, studentët kanë pasur qasje në informacionin në lidhje me mjedisin dhe përbërësit mjedisore, të tilla si ajri, uji, toka, biodiversiteti, kushtet klimatike, ndryshimet për shkak të ngrohjes globale, hollimi i shtresës së ozonit etj. - dhe shpresojmë që të kemi arritur të avancojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre në këtë sferë shumë të rëndësishme.



FSHATI I FËMIJËVE (SOS)

Sharrcemi vazhdoi mbështetjen në vitin 2019 me kontribute të drejtpërdrejta sociale për komunitetin dhe vendin. Këto kontribute ishin financiare ose jo-financiare. Përfituesit e këtij viti përfshijnë individë dhe organizata të ndryshme lokale dhe kombëtare, përfshirë Fshatin e Fëmijëve SOS, të cilin e mbështetëm përmes blerjes së kartolinave stinore të përgatitura nga fëmijët e këtij institucioni. Me blerjen e këtyre kartolinave, ne përqipemi të japim një kontribut të nevojshëm financiar për fëmijët që janë pa kujdes prindëror, por gjithashtu kemi mbështetur iniciativën në mënyrë që të inkurajojmë të tjerët të kontribuojnë për diçka pozitive.

DHURATAT PËR VITIN E RI

Përveç programeve të zhvillimit të komunitetit të cilat Sharrcemi i zbaton, kompania gjithashtu jep kontribute të drejtpërdrejta sociale për komunitetin dhe vendin. Për festat sezonale, ne u kemi shpërndarë Handikosit (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës) si dhe rasteve sociale në komunitetin lokal, dhurata për fëmijë për Vitin e Ri.



DHURIMI I GJAKUT

Kompania jonë u bashkua me këtë fushatë në vitin 2019, dhe shumë nga punonjësit tanë dhe kontraktorët tanë iu përgjigjën

thirrjes. Si në vitet e kaluara, secili donator mori një vakt falas në mensën tonë. Ne mund të themi lirisht se punonjësit e Sharrcemit inkurajohen fuqimisht të vazhdojnë të dhurojnë gjak vullnetarisht.



PROJEKTI ME FËMIJËT E SHKOLLAVE FILLORE

Shprehitë e mira kanë tendencë të zgjasin një jetë të tërë nëse fëmijët mësohen në ditët e para të fëmijërisë së tyre. Ofrimi i ligjëratave/trajnimeve për fëmijët për ndonjë temë të rëndësishme, dhe veçanërisht për shëndetin dhe sigurinë dhe mësimi i tyre se si të sillen ka qenë gjithmonë një objektiv kryesorë për Sharrcemin. Prandaj, një nga hapat drejt rritjes së vetëdijesimit të tyre për mbrojtjen nga zjarri u ndërmor këtë vit përmes një ligjërate/trajnimi të organizuar nga ekipi ynë nga departamenti për shëndet dhe siguri. Përveç ligjëratës/trajnimit të ofruar për nxënësit dhe për punonjësit teknik në shkollat në temën e Mbrojtjes nga Zjarri, ne kemi pajisur të gjitha shkollat në zonë me pajisje për shuarjen e zjarrit. Gjatë kësaj ngjarje, ne shpërndamë materiale promovuese për të gjithë nxënësit në lidhje

me shëndetin dhe sigurinë në përgjithësi dhe për të gjithë fëmijët e kopshteve në Komunën e Hanit të Elezit u shpërndanë dhuratat e Vitit të Ri së bashku me libra edukues.



SKEMA E MENTORIMIT

Rrjeti CSR në Kosovë po zbaton një projekt të UNICEF-it me titull Skema e Mentorimit, i cili synon të kontribuojë në fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve duke rritur kapacitetin dhe aftësinë për të marrë pjesë në fuqinë punëtore, në proceset e politik bërjes dhe vendimmarrjes, përmes mentorëve të sektorit privat ose mentorëve të rinj. Skema e mentorimit ka objektiva dhe modele të ndryshme në varësi të rrethanave të rinisë që ata synojnë. Për shembull, këshillat dhe mbështetja që kërkon një person i ri i cili është duke filluar një biznes është dukshëm më i ndryshëm nga mbështetja që do t'i duhet një të riu që rrezikon të braktisë shkollën. Skema e Mentorimit lidh të rinjtë që marrin pjesë në iniciativat e UNICEF-it me mentorë vullnetarë që vijnë nga sektori privat dhe shoqatat alumni. Sharrcem, si një anëtar themelues i Rrjetit CSR, vazhdon të jetë shumë aktiv në Rrjet duke kontribuar në iniciativat e rrjetit, përfshirë pjesëmarrjen në këtë projekt. Një nga punonjësit tanë kishte për detyrë të jepte trajnime për të rinjtë.

Së pari, ai ndoqi seminarin Trajnimi për Trajnerin të organizuar nga UNICEF-i, dhe më pas mentoroi seminarin përfundimtar, "Generation Unlimited Youth Challenge".



TOKA E DHURUAR PËR KOMUNËN

Komuniteti ynë gjithashtu vuan nga mungesa e mbështetjes së strukturuar për zhvillimin e ndërmarrësisë. Ky ka qenë një objektivi strategjik për Grupin TITAN në Kosovë dhe politika e ndjekur nga Sharrcemi nënvizon angazhimin për të përmbushur këtë qëllim. Ne kemi qenë të hapur dhe transparent duke komunikuar me palët tona kryesore të interesit për të bërë më të mirën dhe për të zvogëluar brengat e komunitetit tonë.

Propozimi i një projekti që ka ardhur direkt nga komuna, ishte për ndërtimin e shtëpisë së kulturës në Komunën e Hanit të Elezit, por për ta bërë këtë, ata kanë kërkuar nga ne që të japim/dhurojmë një parcelë (tokë) brenda rrethojës sonë në mënyrë që të jenë në gjendje që ta ndërtojnë ndërtesën. Deri më tani, të rinjtë e Hanit të Elezit kanë

përdorur një ndërtesë të vjetër për të kryer aktivitetet e tyre të preferuara, dhe kjo nuk u ka dhënë të rinjve hapësirën e merituar për veprimtaritë e tyre. Ne gjithmonë jemi të interesuar të investojmë në avancimin e të rinjve dhe besojmë se një detyrë kaq e rëndësishme fillon duke i bërë ata të ndjehen të lumtur, të angazhuar dhe aktivë.

Çfarë mund të jetë më relaksuese për të rinjtë sesa ta kenë vendin/hapësirën e tyre ku ata mund të shkojnë dhe të shijojnë një sërë lojërash, aktiviteteve dhe iniciativash të tjera kulturore. Prandaj, pas kërkesës së komunës dhe disa takimeve zyrtare midis Sharrcemit dhe komunës, ne ramë dakord që ta japim/dhurojmë parcelën e kërkuar në mënyrë që të ndërtohet ndërtesa e re dhe më e madhe e cila plotëson nevojat e komunitetit tonë për aktivitete të ndryshme kulturore për të rinjtë.



Prona e
Komunës

Prona e
Sharrcemit

RRETHOJA: shtëpia e kulturës është në proces të ndërtimit ku një pjesë ndodhet brenda pronës së fabrikës

KONTRIBUTET SHOQËRORE

Në vitin 2019, ne gjithashtu u përgjigjëm duke i dhënë përparësi çështjeve materiale që janë më të rëndësishme për biznesin tonë dhe për komunitetin. Raporti Vjetor i CSR dhe Qëndrueshmëria për vitin 2019 do të publikohet vitin e ardhshëm, duke përfshirë periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2019 dhe do të ndjekë standardet e raportimit të Grupit TITAN, ku do të shpalosim prioritetet e Sharrcemit që janë të lidhura me OZHQ-të përkatëse. Kontributi shoqëror përfshin një pjesë të rëndësishme të planeve tona të biznesit, prandaj ne mbetemi të përkushtuar ndaj iniciativave të ndryshme për sa i përket qëndrueshmërisë.

OZHQ-TË E MBËSHTETURA PËRMES PROJEKTEVE/INICIATIVAVE TË ZHVILLUARA NË VITIN 2019







3. KONTRIBUTI NË TRANZICIONIN NË KOSOVË

TË DREJTAT E NJERIUT

Të gjithë mund dhe duhet të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut. Sharrcemi ka qenë shumë aktiv për të bashkëpunuar me palët përkatëse të interesit përmes mekanizmit të tij për të ndërmarrë së bashku veprime të cilat do t'i vendosin të drejtat e njeriut në qendër të strategjive të biznesit. Sharrcemi është gjithmonë i gatshëm të ndajë përvojën dhe njohuritë duke theksuar rëndësinë e të drejtave të njeriut në jetën tonë të përditshme. Duke qenë të përkushtuar dhe të angazhuar, ne mund të sjellim ndryshime të qëndrueshme dhe të krijojmë një mjedis më të mirë.

KODI I MIRËSJELLJES NË SHARRCEM

Duke miratuar procedurat e Grupit dhe përmes programeve të integruara, procedurave, politikave të brendshme, manualit të procedurave të prokurimit, ISO-ve dhe Kodit të Mirësjelljes së Grupit, i cili gjithashtu lidhet me çështjet e të drejtave të njeriut dhe korrupsionit, Sharrcemi synon të promovojë praktika etike në biznes dhe të sigurojë që furnizuesit tanë të bëjnë të njëjtën gjë.

KODI I MIRËSJELLJES



POLITIKAT DHE PROCEDURAT

Çështjet e të Drejtave të Njeriut	SA 8000, Funksionale
Të drejtat në punë dhe liria e asociimit	SA 8000, Funksionale
Mundësi të barabarta	SA 8000, Funksionale
Sponsorizimi, donacionet dhe përfshirja e komunitetit	Aktive ndaj Fondacionit lokal/ Memorandumit lokal të Mirëbesimit
Zinxhiri i Furnizimit / Prokurimi	CoCP e Grupit
Preferencë për furnizuesit lokal	PO
Preferencë për banorët lokal, me rastin e punësimit	PO
Angazhimi i kontraktorëve / nën-kontraktorëve lokal	PO
Kopje e DoraObjektivatt të Grupit për Blerje	PO

ZINXHIRI I FURNIZIMIT DHE FURNIZUESIT LOKAL

Sharrcemi zbaton një politikë të qartë të brendshme për punësimin e vendasve dhe i jep përparësi kontraktorëve dhe furnizuesve lokal, dhe kjo gjë i mbështet kontraktorët dhe furnizuesit lokal si një mënyrë për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme dhe për të rritur krijimin e vlerës në komunitetin lokal.

Përveç politikave të tjera, Sharrcemi zbaton standardin (SA 8000) dhe e konsideron atë një mjet të ri me përgjegjësi shtesë për të punuar vazhdimisht në përmirësimin e marrëdhënieve me furnizuesit lokal dhe për të ofruar ndihmë teknike për ta, për të rritur nivelin e bashkëpunimit dhe cilësinë e shërbimit. Duke i dhënë përparësi furnizuesve tanë lokalë, ne përqijemi të përmirësojmë kushtet e jetesës, për sa i përket punësimit në zonën ku veprojmë, pasi ky problem është i përhapur brenda komunitetit.

STANDARDI NDËRKOMBËTAR (SA 8000)

Sharrcemi është ri-certifikuar me standardin SA 8000 dhe kjo certifikatë vlen deri në prill 2022, dhe ky është një standard - sistem ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të punës bazuar në parimet e normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç përshkruhen në Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Përveç iniciativave të tjera, kompania jonë promovon Politikën e Grupit për të Drejtat e Njeriut edhe përmes këtij standardi.



BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT DHE RRJETET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

PËRPIJËKJET KUNDËR KORRUPSIONIT

PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT NË VEND

KËSHILLI I INVESTITORËVE EVROPIAN (EIC)

Sharrceci vazhdon të ketë një vend të fortë në EIC dhe mbështet iniciativat e këshillit për të punuar së bashku në mënyrë që Kosova të bëhet një vend më i mirë për të bërë biznes duke adresuar pengesat kryesore për biznesin në sektorë të ndryshëm dhe duke bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës dhe ministrinë përkatëse për të eliminuar çdo pengesë të mundshme.

EIC:

- Mbështetë aktivisht integrimin ekonomik në BE dhe ka një aftësi unike për të qenë një pikë qendrore e sektorit privat në procesin e integritimit në BE pasi 100% e anëtarëve të këshillit janë nga BE-ja.
- Promovon praktikën më të mirë të biznesit në BE.
- Jep rekomandime konkrete dhe praktike se si të përmirësohet klima e biznesit.

9

Vende të BE-së të përfaqësuara

18

Rekomandime nga hulumtimi i janë prezantuar Qeverisë

Gjatë vitit 2019, EIC tregoi angazhimin dhe zotimin e saj drejt krijimit të një mjedisi më të favorshëm për investime të huaja direkte në vend, dhe ishte një zë i rëndësishëm në lidhje me rëndësinë e investimeve në sektorin privat.

Ata gjithashtu kanë qenë shumë aktive në rritjen e vetëdijesimit për sa i përket rëndësisë së investimeve të huaja për zhvillimin ekonomik në vend.

Anëtarët e EIC-së:



Anëtarët e Nderit të EIC-së



PROMOVTIOMI I PUNËS DREJT ARRITJES SË OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

BASHKËPUNIMI VAZHDON ME RRJETIN CSR KOSOVA

Rrjeti i CSR në Kosovë u themelua në vitin 2011, si rrjeti i parë i biznesit i themeluar në Kosovë për CSR nga anëtarët e tij themelues, dhe ka qenë shumë aktiv në vitin 2019. Rrjeti është angazhuar për të tërhequr biznese të reja në promovimin e CSR-it sa më shumë që të jetë e mundur në të gjithë Kosovën. Të jesh anëtar i CSR në Evropë përbënë edhe një hap tjetër për Rrjetin drejt integritetit të mëtijshëm të organizatave kosovare në strukturat evropiane. Rrjeti CSR zbaton Dhjetë Parimet e Kompaktit Global, i cili është një kornizë e bazuar në parime për bizneset, duke deklaruar dhjetë parime në fushat e të drejtave të njeriut, të punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit.

Rrjeti vazhdoi me qëllimin e tij për të rritur vetëdijesimin e bizneseve për nevojën e një sjelljeje të përgjegjshme dhe proaktive ndaj komunitetit dhe mjedisit në të cilin vepron një kompani e caktuar.

Duke ndjekur planin strategjik që është krijuar, në vitin 2019 Rrjeti zbatoi disa projekte me një fokus të madh në fuqizimin e të rinjve, mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve, mbështetjen e të rinjve dhe qëndrueshmërinë dhe promovimin e punës drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Projekti i UNICEF-it

Skema e Mentorimit, është një projekt i UNICEF-it i zbatuar nga Rrjeti CSR Kosova i cili synon të kontribuoj në fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve duke rritur kapacitetin dhe aftësinë për të marrë pjesë në fuqinë punëtore, në proceset e politik bërjes dhe vendimmarrjes, përmes mentorëve të sektorit privat ose mentorëve të rinj.

Skema e mentorimit ka objektiva dhe modele të ndryshme, në varësi të rrethanave të rinisë që ata synojnë. Skema e mentorimit i lidh të rinjtë që marrin pjesë në iniciativat e UNICEF-it me mentorët vullnetarë që vijnë nga sektori privat dhe shoqatat alumni.



Mentorët që marrin pjesë në këto iniciativa konsiderohen vullnetarë të UNICEF-it dhe ata kanë marrë certifikata nga UNICEF-i dhe partneri që zbaton projektin duke ua njohur punën vullnetare që ata bëjnë. Para se të bëhen zyrtarisht mentor, të gjithë vijnë kurset në internet lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe ngacmimet seksuale dhe vijnë trajnimin 'Human Centered Design'.

Sharrceci gjithashtu kontribuoi në këtë projekt duke dërguar një nga punonjësit e tij, inxhinierin e Teknologjisë Informative, z. Isa Qajani. Pjesëmarrja e punonjësit tonë ishte e një rëndësie të madhe për të personalisht pasi ishte një mundësi për të bashkëvepruar me palë të ndryshme të interesit dhe për të mbështetur iniciativat e Rrjetit CSR në mënyra të ndryshme.



DITA E TOKËS

Rrjeti CSR Kosova, vazhdon të jetë i angazhuar me shoqërinë përmes aktiviteteve përkatëse në fusha të ndryshme që adresojnë shumë sfida me të cilat përballen shoqëria jonë. Një ngjarje me shëtitje u organizua për të shënuar Ditën e Tokës me qëllim për të mbledhur fonde për mbjelljen e pishave në

komuna të ndryshme dhe ngritjen e vetëdijes duke promovuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Sharrceci kontribuoi në këtë ngjarje duke blerë bileta për të marrë pjesë në shëtitje dhe Rrjeti ka treguar angazhimin e tij duke organizuar dhe mbështetur aktivitete që ndikojnë në mirëqenien e shoqërisë.

NDËRMARRJET E KOSOVËS DISKUTOJNË PËR ANGAZHIMIN E TYRE NDAJ NJERËZVE DHE MJEDISIT

Gjatë Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës, Rrjeti në bashkëpunim me GIZ-in (The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) organizuan një tryezë të rumbullakët të nivelit të lartë me temën “Biznesi i Përgjegjshëm”. Ngjarja tërhoqi pjesëmarrjen e shumë organizatave dhe kompanive të gatshme për të kontribuar në shoqërinë dhe mjedisin e Kosovës përmes iniciativave të ndryshme për CSR. Tryeza u përqendrua në mënyrat në të cilat koncepti i Përgjegjësisë Shoqërore Korporative mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Pjesëmarrësit folën për përpjekjet që kompanitë mund të ndërmarrin në menaxhimin e efekteve shoqërore, mjedisore dhe ekonomike si rezultat i punës së tyre duke qenë të përgjegjshëm ndaj shoqërisë.

Ata gjithashtu vlerësuan mundësitë për transformimin e bizneseve për të ndjekur inovacione sociale dhe mjedisore. Rrjeti i CSRKosova theksoi rëndësinë e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm duke promovuar konceptin, idetë dhe veprimet konkrete që kontribuojnë në avancimin e CSR-it në shoqërinë e Kosovës. U theksua gjithashtu rëndësia e rrjetit si një platformë për të bërë bashkë kompanitë dhe organizatat e përgjegjshme ndaj shoqërisë në Kosovë me qëllim të krijimit të ndryshimeve pozitive në shoqëri. Gjatë konferencës, Sharrceci prezantoi politikën për CSR, qasjen dhe aktivitetet që i ndërmerr kompania në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

SAMITI PËR OZHQ-të NË BRUKSEL

Rrjeti i CSR Kosova së bashku me përfaqësuesit e bizneseve që janë anëtare të rrjetit, përfshirë Sharrcecin, morën pjesë në Samitin për OZHQ-të në Bruksel. Fjalimet dhe ndarja e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm nga folësit, shërbyen si një frymëzim për Rrjetin që të punojë më shumë drejt “Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”. Në Samitin e Brukselit, Drejtoresha Ekzekutive, Linda Tahiri, ishte një nga folësit në Tryezën e Rumbullakët të Punësimit të të Rinjve të Shekullit 21, ku ndau praktikën dhe aktivitetet tona që shërbyen si udhëzues për vendet në zhvillim. Rrejtë CSR Kosova u përfaqësua në Asambleenë e Përgjithshme të CSR Evropë, ku Drejtori Ekzekutiv kishte të drejtë të votojë për planifikimin e aktivitetit dhe çështjet tjera kryesore të Rrjetit Evropian.

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (OZHQ-të)

Në dhjetor, me ftesë të Koordinatorit të OKB-së për Kosovë, ekipi i Rrjetit të CSR festoi së bashku me OKB-në dhe partnerë të tjerë, punën e kryer në vitin 2019 drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së OKB-së për vitin 2030. Zyra e OKB-së në Kosovë është një ngambështetësit kryesorë të Rrjetit CSR Kosova dhe Rrjeti është i lumtur dhe i kënaqur për partneritetin e tij dhe pret që të bashkëpunojë në më shumë projekte në të ardhmen. Rrjeti ishte gjithashtu i pranishëm në takime të ndryshme, punëtori dhe tryeza të rumbullakëta dhe ishte shumë aktiv në diskutimin e rëndësisë së qëndrueshmërisë.

SHARRCEMI NË KUADËR TË RREJTIT

Sharrceci ishte shumë i zëshëm në Bord dhe tregoi përkushtim për të mbështetur Rrjetin CSR Kosova duke ndarë përvojën / projektet e tij, të fokusuara në zgjidhje praktike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Sharrceci mbetet i bindur se zbatimi i politikave dhe strategjive të CSR-it në agjendën e tij të përditshme në biznes, përbën një mekanizëm të rëndësishëm në mënyrë që të gjithë të adresojnë sfidat e shumta me të cilat përballet shoqëria jonë.

RRJETI SHËNON DITËN BOTËRORE KUNDËR KORRUPSIONIT

Rrjeti CSR në Kosovë dhe anëtarët e tij janë plotësisht të përkushtuar për të demonstruar gatishmërinë e tyre për


mobilizim të përbashkët për të luftuar sjelljen korruptive. Ne fuqimisht besojmë se ata që zbatojnë (#CorporateSocialResponsibility) duhet t'i japin prioritet luftës kundër korrupsionit.



Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova



PUNOJNË SË BASHKU PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM







4. MJEDISI NATYROR



MENAXHIMI I INTEGRUAR I MJEDISIT NGA SHARRCEMI

Që nga fillimi i vitit 2010, Sharrcemi pranoi rëndësinë e mbrojtjes mjedisore dhe që nga ajo kohë një numër iniciativash janë zbatuar për të inkurajuar dialogun e palëve të interesit dhe për të kërkuar informata kthyesë (feedback) për çështjet materiale, siç janë ndikimi i punës sonë në mjedis. Në vitin 2018, TITAN-i publikoi Politikën e Rishikuar të Grupit për Mjedis duke zëvendësuar politikën e lëshuar në vitin 2008. Versioni i azhurnuar ka një qasje më holistike ndaj qëndrueshmërisë së mjedisit, në përputhje me premtimin e kompanisë ndaj OZHQ-ve të Agjendës së OKB-së për vitin 2030, pritshmërive të palëve të interesit dhe çështjet materiale. Zvogëlimi i ndryshimeve klimatike dhe adaptimi ndaj saj janë pjesë e politikës së rishikuar.

Politika e re e grupit synon të forcojë më tej kulturën e përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë organizatën dhe adreson më konkretisht çështjet që lidhen me menaxhimin e mjedisit, duke integruar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të industrisë, si në vijim:

- Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimeve të aktiviteteve të Grupit në mjedis dhe shoqëri

- Ruajtja e tokës përmes rehabilitimit të guroreve
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve lokale
- Ruajtja e burimeve ujore
- Përsheptimi i përpjekjeve për rikuperimin e burimeve, zvogëlimin e mbeturinave dhe menaxhimin e përgjegjshëm të mbeturinave
- Përdorimi i inovacionit në strategjinë për mjedis
- Promovimi i qëndrueshmërisë në zinxhirin e furnizimit duke inkorporuar kritere të qëndrueshme në procesin e prokurimit

Duke marrë parasysh natyrën tonë të punës që ndikon në mjedis, por gjithashtu duke u varur nga përdorimi i burimeve natyrore, kujdesi ndaj mjedisit mbetet një nga prioritetet tona më të mëdha në të gjitha aspektet e strategjisë sonë të planit për punë. Emetimet në ajër, zhurma, energjia, materialet natyrore dhe konsumi i ujit janë çështje që lidhen me performancën tonë të përditshme dhe si rezultat, ne bëjmë përpjekje dhe investime të vazhdueshme, në mënyrë që të zvogëlojmë efektet e tyre sa më shumë që të jetë e mundur.



Angazhimi me palët kryesorë të interesit është gjithashtu shumë i rëndësishëm dhe qëllimi ynë është të stimulojmë vetëdijesimin mjedisor për komunitetin ku veprojmë. Sharrcepi adreson këto çështje kryesore mjedisore përmes qasjes tonë të CSR.

- Ndryshimi klimatik
- Energjia dhe lënda e parë
- Emetimet në ajër dhe emetimet tjera
- Biodiversiteti
- Uji

Sharrcepi respekton të gjitha rregulloret lokale dhe kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, dhe i është akorduar leja IPPC (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes) e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo ishte leja e parë e lëshuar ndonjëherë në Kosovë dhe ne duhet të theksojmë se investimi i jashtëzakonshëm i nivelit më të lartë i bërë nga kompania dhe bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me autoritetet kanë mundësuar që të përmbyllet ky proces shumë i rëndësishëm. Sharrcepi kujdeset për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, kështu që ne qëndrojmë vigjilent dhe të përkushtuar si pjesë e Grupit TITAN për “të bërë më pak dëm dhe për të dhënë më shumë të mira” në menaxhimin dhe përmirësimin e performancës sonë

mjedisore edhe gjatë rrethanave të vështira ekonomike. Për më shumë hollësi, referojuni pjesës në SHTOJCA – tek Seksioni i KPI-ve për Indeksin e Performancës ndaj Mjedisit me të dhënat e konsoliduara për tri vitet e fundit (2017-2019).

KOMITETI VJETOR I KOMPANIVE PËR MJEDISIN (CEC)

Takimi i Komitetit të Kompanive për Mjedisin (CEC) u mbajt në fillim të vitit për të analizuar, diskutuar dhe aprovuar programet mjedisore, planet e veprimit, raportin vjetor të vitit paraprak dhe treguesit e performancës mjedisore për vitin përkatës.

AKTIVITETET KRYESORE NË VITIN 2019

- Ri-certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015 u bë në nëntor 2019.
- Sharrcepi iu nënshtrua një procesi të auditimit të brendshëm nga data 25 nëntor deri më 06 dhjetor 2019 në lidhje me performancën mjedisore dhe raportimin në vend.

Nuk është gjetur asnjë mospajtueshmëri.



PËRMIRËSIMET NË MJEDIS

Sharrceci ka krijuar që nga viti 2011 një plan masash për të adresuar çështjet/shqetësimet e palëve të interesit përmes programeve të përmirësimeve në mjedis. Këto programe në vitin 2019 u referohen aktiviteteve të mëposhtme:

- Projekti i izolimit për magazinimin e klinkerit (zgjyrës) dhe lëndës së parë ka vazhduar me mbylljen e pjesëve veriore dhe jugore dhe ka përfunduar në mars 2019. Deri më tani investimi i përgjithshëm ka arritur në 0.388 milion Euro (në mënyrë kumulative që nga fillimi i programit të përmirësimit).
- Instalimi i sistemit për parandalimin e përhapjes së pluhurit gjatë shkarkimit të

lëndës së parë – gurit gëlqeror në hinkë dhe mbyllja e saj me shirita gome duke mundësuar zvogëlimin e përhapjes së pluhurit nga ky burim i emetimeve. Deri më tani janë investuar më shumë se 0.015 milion Euro (në mënyrë kumulative).

- Plan i për rehabilitimin e gurores së mergelës në Dimcë (plani i rehabilitimit 15 vjeçar) vazhdoi në sipërfaqen e tretë të zbrazët E-450 përmes rehabilitimit teknik dhe mbjelljes së 300 fidanëve të reja. Deri më tani janë mbjellë më shumë se 1200 drunj të rinj, që nga fillimi i programit të rehabilitimit të gurore në vitin 2014 (në mënyrë kumulative).

REHABILITIMI I GURORES DHE BIODIVERSITETI

Plani i përmirësuar/i vazhdueshëm për rehabilitimin e gurores – të Gurores në Dimcë, për periudhën 5- vjeçare, 2016-2020 është në progres dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2019 u kryen në përputhje me rrethanat. Objektivi i planit të rehabilitimit të Gurores në Dimcë është restaurimi i pusit të zbrazur, përmes mbjelljes së drunjve në sipërfaqet e zbrazëta dhe mbushja dhe nivelimi i platformës së gurores. Zbatimi i planit të rehabilitimit në gurore doli të jetë një shembull praktik i ruajtjes dhe kthimit të resurseve natyrore në një gjendje të përputhshme me mjedisin përreth dhe është sipas nevojave të palëve lokale të interesit.

Për herë të parë që nga viti 2013, kompania ka në funksion Instrumentin e Vlerësimit të Integruar të Biodiversitetit (IBAT) për të ekzaminuar vlerën e biodiversitetit në zonën ku vepron. Punishtet në të cilat vepron Sharrceci do të jenë pjesë e projektit të Grupit në vitin 2020 për vlerësimin e statusit dhe vlerës së biodiversitetit të gjitha gurore të Grupit, duke e përdorur Instrumentin IBAT. Megjithatë punishtet tona nuk njihen për vlerën e lartë të biodiversitetit deri më tani, ky vlerësim do të ndihmojë Sharrcecin të azhurnojë statusin dhe rreziqet e mundshme, në mënyrë që të vendosë për veprime specifike aty ku është e përshtatshme/nevojshme.

EKONOMIA QARKORE SI PJESË E PUNËS SË SHARRCEMIT

Duke marrë parasysh që menaxhimi i mbeturinave është pranuar të jetë një nga sfidat kryesore për Kosovën për shumë vite tani, SharrCemi ka investuar dhe vazhdon të investojë duke synuar të kontribuojë në:

- (a) Zvogëlimin e përdorimit të lëndës së parë nga natyra (nga guroret e SharrCemit si dhe lëndën e parë nga palët e treta).
- (b) Zvogëlimin e djegies së mazutit, thëngjillit, linjtit dhe lëndëve tjera djegëse natyrore (të nxjerra nga toka), si burime për energji në operacionet e prodhimit, gjithashtu zvogëlimin e përdorimit të lëndëve djegëse të tjera industriale si koksi i naftës (duke qenë nënprodukt të rafinerive).
- (c) Rikuperimin e nënprodukteve industriale (përfshirë nënproduktet e mbetjeve të industrive të tjera), dhe zëvendësimi i lëndëve të para natyrore dhe lëndëve djegëse natyrore me nënprodukte të tilla industriale, për bashkë-përpunimin dhe prodhimin e klinkerit (zgjyrës) dhe çimentos si produkt përfundimtar.
- (d) Efikasitetin e burimeve për Kosovën (duke kontribuar në planet kombëtare për zvogëlimin e varësisë nga lëndët e para dhe lëndët djegëse të importuara).
- (e) Minimizimin e mbetjeve nga operacionet vetanake, dhe gjithashtu duke kontribuar në planet lokale dhe kombëtare për minimizimin e nevojave për deponimin e mbeturinave të tilla në deponi.

Duke pasur parasysh angazhimin dhe ambicien e mësipërme, SharrCemi ka filluar që nga viti 2011 për të investuar në objektet e veta dhe në instalimet dhe pajisjet e palëve të treta (të tilla si KEK-u*) dhe qëllimi është të haxhojë/bashkë-përpunojë/përdorë një portofol burimesh, në veçanti:

- Hirin e thatë, nga impiantet industriale të KEK-ut në zonën e Obiliqit (Kosovë): SharrCemi ka harxhuar më shumë se 94,800 tonë në vitin 2019 dhe ka tejkaluar 915,862 tonë të harxhimit total që nga viti 2011 (në mënyrë kumulative). Ky nënprodukt industrial përdoret si një material zëvendësues në përpunimin e bluarjes së

çimentos, në vend të puzzolanas dhe gurit gëlqeror të cilat janë lëndë e parë natyrore.

- Hirin fundërrues, nga impiantet industriale të KEK-ut në zonën e Obiliqit: Ky material përdoret si zëvendësues i lëndëve djegëse natyrore ose/dhe i koksit të naftës, dhe gjithashtu zëvendëson lëndët e para natyrore siç është guri gëlqeror, në bashkë-përpunimin e prodhimit të klinkerit (zgjyrës) në furrën e çimentos. SharrCemi ka harxhuar më shumë se 9,643 tonë në 2019 dhe ka tejkaluar 58,706 tonë të harxhimit total që nga viti 2011 (në mënyrë kumulative).
- Hirin e piritit, nga impiantet industriale të Trepçës në zonën e Mitrovicës (Kosovë): SharrCemi ka harxhuar më shumë se 6,030 tonë në 2019 dhe ka tejkaluar 42,579 tonë të harxhimit total që nga viti 2016 (në mënyrë kumulative). Ky nënprodukt industrial ka përmbytje të lartë të hekurit dhe përdoret si një material zëvendësues në vend të lëndëve tjera të para të cilat janë të pasura me hekur, të tilla si argjila dhe mergelja. Hiri i piritit është gjithashtu një zëvendësim i përsosur për nënproduktet e ngjashme të importuara nga vendet fqinje të cilat kanë përmbytje të lartë të hekurit (kjo praktikë ka ekzistues në të kaluarën, ku burime të hirit të ngjashëm të piritit janë importuar p.sh. nga Shqipëria). Për më shumë detaje, shikoni faqen "96".

Veç kësaj, për të mbrojtur mjedisin dhe për të rritur aftësinë konkurruese, SharrCemi po adreson zëvendësimin e pjesshëm të lëndëve djegëse fosile me lëndë djegëse alternative. SharrCemi po synon të përdorë Lëndë Djegëse RDF (Refuse Derived Fuels) dhe gjithashtu Karburante të Tjera Alternative (AF) me origjinë nga mbetjet komunale, komerciale dhe industriale për përdorim si një burim shtesë i energjisë në furrën e klinkerit. Ne jemi të gatshëm dhe synojmë të promovojmë përdorimin e karburanteve alternative në vend, duke përmirësuar kështu pozitën, suksesin dhe qëndrueshmërinë e biznesit, gjithashtu duke siguruar dobi të rëndësishme mjedisore, ekonomike dhe shoqërore për të gjithë.

PERFORMANCA MJEDISORE

SISTEMI PËR MONITORIMIN E VAZHDESHËM TË EMETIMEVE

Monitorimi i emetimeve është një parakusht për kontrollimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis nga prodhimi i çimentos. Kompania jonë ishte kompania e parë në Kosovë që prezantoi sisteme të pavarura të monitorimit të vazhdueshëm, duke operuar 24 orë në ditë përmes një sistemi automatik të monitorimit

të vazhdueshëm i cili është instaluar në vitin 2012 dhe i cili kalibrohet dhe certifikohet nga një palë e pavarur sipas Standardeve Evropiane. Të dhënat që dalin nga vlerat e matura përpunohen duke përdorur softuerin e licencuar i cili është azhurnuar në qershor 2019 - MEAC 300. Vlerat e përpunuara paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore dhe dorëzohen rregullisht në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

EMETIMET NË AJËR

Emetimet e SOx [mg/Nm³]




Emetimet e NOx [mg/Nm³]



Emetimet e pluhurit – ftohësi i klinkerit cooler [mg/Nm³]





NDRYSHIMI KLIMATIK

Ndryshimi klimatik vazhdon të konsiderohet si sfida më e rëndësishme mjedisore e kohës sonë. Natyra e industrisë së çimentos është e tillë që prodhon dhe lëshon dioksid karboni (CO₂), duke kontribuar kështu në efektin serë dhe ndryshimin e klimës. Sharrcepi vazhdimisht përpiqet të adresojë sfidat e përcaktuara mjedisore përmes planifikimit të kujdesshëm dhe ndërmarrjes së veprimeve, të shoqëruara me investimet e nevojshme.

Në vitin 2013, Sharrcepi i përfaqësuar nga Menaxheri i tij për Mjedis, duke vepruar si konsulent kombëtar, mori pjesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes për Kosovën. Si një kontribut në ndërtimin e kapaciteteve dhe përafrimin e

strategjive afatmesme dhe afatgjata, u krijua ekipi shkencor për të siguruar mbështetje për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës.

Në ndjekim strategjinë e miratuar të TITAN-it për zvogëlimin e ndikimit në ndryshimet klimatike e cila pasqyrohet në politikën e tyre për mjedisin dhe ajo drejton Iniciativën tonë të Grupit për sa i përket CO₂.


Në vitin 2019, kemi arritur të zvogëlojmë emetimet tona specifike të CO₂, kryesisht për shkak të zvogëlimit të faktorit të klunkerit (zgjyrs) në çimento, dhe kjo është arritur duke përdorur sasi të shtuara të lëndëve të para alternative dhe të përshtatshme.

MENAXHIMI I UJIT


Duke ndjekur standardet dhe udhëzimet më të vlefshme ndërkombëtare të sektorit të çimentos (Udhëzimet e GCCA-së për monitorimin dhe raportimin e ujit të përdorur në prodhimin e çimentos), Sharrceci monitoron vazhdimisht sasinë totale të ujit të përdorur në fabrikë dhe renditet në një nivel shumë të mirë sipas standardeve të tilla.

Investimet në sistemet e riciklimit të ujit dhe përmirësimet në rrjetet ekzistuese të ujit kanë çuar në përdorim më efikas të ujit, ndërsa krijimi dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit të ujit ka përmirësuar monitorimin e përgjithshëm dhe ka bërë që raportimi i përdorimit dhe konsumit të ujit të jetë më i qëndrueshëm.

SASIA TOTALE E UJIT TË PËRDORUR PËR PRODHIMIN E ÇIMENTOS



PËRDORIMI SPECIFIK I UJIT PËR PRODHIMIN E ÇIMENTOS



DERDHJA TOTALE E SASISË SË UJIT NGA WWTP (Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza)



CILËSIA E UJIT TË DERDHUR JASHTË FABRIKËS/IMPIANTIT

Impianti për trajtimin e ujërave të zeza (WWTP) është futur në përdorim dhe funksionon që nga viti 2016 për trajtimin e të gjitha ujërave të zeza. Sharrcemi monitoron cilësinë e ujit të derdhur jashtë fabrikës / impiantit, në baza tremujore përmes laboratorëve të akredituar. WWTP ka qenë në funksionim të vazhdueshëm gjatë vititraportues

dhe gjatë kësaj kohe nuk ka ndodhur asnjë problem në funksionim. Rezultatet e analizave kimike nga uji i shkarkuar ishin brenda kufizimeve dhe limiteve sipas vlerës së limiteve për shkarkimin e ujit nga impiantet për trajtim, ashtu siç përcaktohet në udhëzimin administrativ, (UA-30/2014).

Përmes funksionimit të WWTP-së, Sharrcemi ndihmoi disa familje rreth fabrikës, në komunën e Hanit të Elezit, duke u siguruar atyre lidhjen dhe tretmanin e ujërave e zeza në prona të fabrikës. Një numër i konsiderueshëm i familjeve të komunës përfituan nga rregullimi i tubave të ujit dhe lidhja e duhur me sistemin e ujërave të zeza të kompanisë. Investimi në këtë WWTP kontribuoi jo vetëm në mbrojtjen e mjedisit por edhe në shëndetin e komuniteteve lokale përreth.

PARAMETRAT E CILËSISË NË WWTP		VLERA E LIMITEVE - SIPAS UA-30/2014	CILËSIA PARA TRAJTIMIT	CILËSIA PAS TRAJTIMIT
			2019	
pH		6-8.5	8.02	7.38
Nevoja Kimike për Oksigjen (COD)	mg/l O ₂	125	438.38	45.60
Nevoja Biokimike për Oksigjen (BOD ₅)	mg/l O ₂	25	224.25	12.40
Lënda e Ngurtë Pezull Në Total (TSS)	mg/l	60	164.08	30.70
Vaj dhe Yndyrë	mg/l	10	1.22	0.45
TOC	mg/l	40	149.43	23.25

MENAXHIMI I MBETURINAVE

Një zonë e veçantë e përcaktuar, në afërsi të vendeve ku krijohen mbeturina, përdoret për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve të ngurta të mbajtura në kuti, kontejnerë ose vende të zgjedhura siç duhet dhe të shënuara/etiketuara posaçërisht për një qëllim të tillë. Depozitimi i mbeturinave kryhet nga nënkontraktorët që kanë leje, dhe ata ofrojnë shërbime në lidhje me mbledhjen dhe/ose transportimin e

mbeturinave. Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet duke zbatuar rregullin e përparësisë që u jepet: ripërdorimit, riciklimit dhe ripërpunimit.

Sasia e mbetjeve të krijuara dhe të shkatërruara në vitin 2019 si dhe mbetjet e përdorura nga fabrika në të njëjtin vit.

MBETJET E KRIJUARA

Viti	Mbetje të brendshme të përziera (t/v)	Skrup (t/v)	Tullat rezistente ndaj zjarrit (t/v)	Thasë të grisura të çimentos (t/v)	Mbetje nga letra dhe paketimi (t/v)	Mbetjet nga shembja/demolimet	Paletat nga druri (m³/y)	Mbetjet nga vaji (t/y)
2019	46.14	118.96	200	33.48	11.3	194	43.83	2

SHFRYTËZIMI I MBETJEVE (JO TË LËNGËTA)

Viti	Hiri i thatë (t/v)	Hiri fundërrues (t/y)	Piriti (t/y)	Tullat rezistente ndaj zjarrit (t/y)
2019	94,800	9,643	6,030	0

VETËDIJESIMI PËRMES TRAJNIMEVE

Sharrcemi i cili është pjesë e një industrie që ka një ndikim në mjedis vazhdon bashkëpunimin e ngushtë me palët e interesit edhe përmes departamentit për mjedis duke organizuar trajnime dhe duke i hapur dyert e veta për të mirëpritur palët e interesit për vizita.

Departamenti për mjedis, sipas aktiviteteve të planifikuara, organizoi programe dhe aktivitete të ndryshme trajnimi duke u fokusuar në kontributin ndaj arsimit dhe

shoqërisë dhe duke rritur vetëdijesimin në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Sharrcemi gjithashtu dha kontributin e tij në ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtjen e mjedisit në vend duke dhënë materiale dhe një ligjëratë me qëllim që të ngritë kapacitetet dhe të ndajë njohuritë për ndikimet e ndryshimeve klimatike në tokë. Për më shumë informacion, shih SHTOJCËN “A”, Seksioni i KPI-ve për Indeksin e Performancës Sociale “SP39L”.





5. RAPORTI I PAVARUR I GARANCISË SË KUFIZUAR

Independent limited assurance report

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.granthornton-ks.com

To the management of Sharrcem SH.P.K.

Introduction and scope of work

We were engaged by Sharrcem SH.P.K. (further referred as to “the Company”), to provide limited assurance in relation to the following information, presented in Sharrcem SH.P.K. Corporate Social Responsibility and Sustainability Annual Report for 2019 (further referred as to “the CSR and Sustainability Report”):

- The consistency of qualitative and quantitative sustainability disclosures presented, with regard to the UN Global Compact principles and specifically to the Advanced Level of Communication on Progress Report criteria.
- The completeness and accuracy of qualitative and quantitative sustainability disclosures, in specific for the areas of Environment and Health & Safety and regarding the criteria applicable in 2019, which are aligned with the sectoral guidelines and reporting standards (GCCA¹ Sustainability Charter, GCCA Sustainability Framework Guidelines, and other relevant and applicable GCCA Guidelines, and the guidelines of the World Business Council for Sustainable Development / Cement Sustainability Initiative (WBCSD/CSI) only as applicable in 2019), and with the TITAN Group² Standards for Reporting on Group level and Business Unit level.
